Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare", Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k. është rregjistruar si person juridik shqiptar, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Nr. 6754, datë 15.0.1997, me Seli në rrugën "Ndre Mjeda", Tiranë, Shqipëri.

Më datën 24.02.2006, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Albeton 5" shpk, i cili zotëron 100%(njëqindpërqind) të kuotave të kësaj shoqërie në kapitalin e saj, për arsye objektive ka vendosur të largohet nga Shoqëria "Albeton 5" Shpk.

Me Vendimin Nr. 43, të datës 24.02.2006, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, është vendosur :

- Largimi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, Shoqëria GGIF Investimenti Srl, për arsye objektive nga Shoqëria "ALBETON 5" Shpk, dhe transferimi nëpërmjet shitjes të të gjitha kuotave të zotëruara prej tij, që përfaqësojnë respektivisht 100%(njëqindpërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Albeton 5", duke ia shitur personit të mëposhtëm :

- Z. Artan Dulaku, i cili pranon dhe ble 100% (Njëqind përqind) të pjesëve të kuotave në kapitalin e Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, me nje vlere totale prej € 1.000.000/00(njëmilion Euro), i cili pas shitjes do të bëhet pronar i vetëm në kapitalin e Shoqërisë Albeton 5" Shpk, me 100%(njëqind përqind) të kuotave të kapitalit.

- Kryerjen e të gjithë procedurave ligjore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në kolonat përkatëse të Regjistrit Tregtar.

Me anë të Kontratës së Shitjes së Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, me Nr.Rep.991, dhe Nr.Kol.393, datë 24.02.2006, të hartuar dhe nënshkruar para Noteres Mimoza Sadushaj, të Dhomës së Noterisë Tiranë, është bërë shitja e 100%(njëqindpërqind) të kapitalit që zotëron Shoqëria "GGIF Investimenti "S.r.l., në favor të Z.Artan Dulaku, me një vlerë prej € 1,000,000/00(njëmilion Euro), vlerë e cila është likujduar totalisht nga blerësi në shumën e dhënë, dhe nuk ka ndaj shitësit asnjë detyrim financiar, e vërtetuar kjo nëpërmjet aktit

noterial, Marrëveshje private e vërtetimit, me Nr.Rep. 2331 dhe Nr. Kol. 435, datës 18.03.2006, të noteres publike Ruko Sako, të Dhomës së Noterisë Tiranë.

Pas transferimit të kuotave nëpërmjet shitjes, ortak i vetëm i kësaj shoqërie do të jetë :

- Artan Dulaku, i cili bëhet pronar i vetëm me 100%(njëqindpërqind), të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk.

Shoqëria e mësipërme nuk bën ndryshime të tjera të cilat mbeten ashtu siç kanë qenë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Vendimit Nr. 43, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, të datës, 24.02.2006, dhe të Kontratës së Shitjes së Kuotave të Kapitalit me Nr. Rep.991, dhe Nr. Kol.393, datë 24.02.2006, çmova se kërkesa e kërkuarit është e drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE;


dhe në bazë të ligjit 7638 datë 19.11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare", si dhe të ligjit Nr.7667, datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare",

VENDOSA:

- Pranimin e Kërkesës.
- Depozitimn në Zyrën e Regjistrin Tregtar, të Vendimit Nr. 43, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Sh.p.k, të datës 24.02.2006.
- Depozitimn në Zyrën e Regjistrin Tregtar, të Kontratës së Shitjes së Kuotave të Kapitalit, të datës 24.02.2006, me Nr.Rep.991, dhe Nr. Kol.393, datë 24.02.2006.
- Urdhërimin e Zyrës së Regjistrin Tregtar, që të bëjë ndryshimet përkatëse në kolonën __, gërma __, dhe të bëhet ndarja nga njëri tjetri me vizë të kuqe.
- Ndaj këtij Vendimi Lejohet ankim sipas ligji.

Tiranë më 17 / 07 / 2006

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
Vendimi nr. 6754/12

VENDIM I GJYQTARIT TË VETËM
-Për depozitimimin e akteve të Personit Juridik-

Sot, më datë 12.04. 2007 (dymijë e shtatë), unë gjyqtarja Elisaveta Dini në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Albeton 5" shpk, e përfaqësuar nga Ortaku i Vetëm Z. Artan Dulaku, për depozitimimin në regjistrin tregtar të vendimit nr. 44, datë 04.04.2007, të Ortakut të Vetëm të kësaj shoqërie, si dhe dokumentat e tjera bashkëlidhur kërkesës. Pasi shqyrtova kërkesën dhe u njoha me aktet përkatëse,

KONSTATOVA SE:

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare", Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k. është rregjistruar si person juridik shqiptar, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Nr. 6754, datë 15.0.1997, me Seli në rrugën "Ndre Mjeda", Tiranë, Shqipëri, dhe kapital themeltar të shoqërisë në vlerë prej 6,367.252 (gjashtëmilion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) Lekë, me Ortak të Vetëm të shoqërisë, Z. Artan Dulaku, i cili zotëron 100% (njëqindpërqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Me Vendimin Nr. 44, të datës 04.04.2007, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, është vendosur :

1. Ndryshimi i Selisë së Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, të ndodhur në adresën rruga "Ndre Mjeda", Tiranë, në adresën e mëposhteme :
 - Rruga "Perlat Rexhepi", Godina me 2÷13 Kate, Kati i 2, Tiranë, Shqipëri.
2. Të pranojë të përfunduar nga detyra e Këshillit Administrativ të shoqërisë, të emëruar me Vendimin e Gjyqtarit të Vetëm Nr. 6754/3, datës 19.03.2003, duke filluar prej datës 19.09.2006, të përfundimit të afatit trevjeçar, dhe i revokon atyre të gjitha kompetencat e dhëna duke e konsideruar detyrën e tyre, si këshill administrativ të përfunduar.
3. Duke e konsideruar të nevojshëm emërimin e një administratori të ri, ortaku i vetëm i shoqërisë, vendos të emërojë duke filluar nga data 04, Prill 2007, Z. Sotiraq Toshi, i biri i Mihallaqit dhe i Donikës, i datëlindjes 17, Shtator 1969, lindur në Korçë, shtetas shqiptar, banues në adresën : rruga "Qemal Stafa" pallati nr.188, shkalla nr.1, apartamenti 2, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me nr.Z.1667349, i cili pranon detyrën e Administratorit Ligjor të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk.
4. Të ndryshojë Nenin 16 të Statutit, si më poshtë :

ADMINISTRIMI

Administrimi i shoqërisë i besohet një apo disa administratorëve, të zgjedhur edhe nga jo ortakët, të emëruar nga asambleja. Kohëzgjatja e detyrës së administratorit/ëve është për një periudhë të pacaktuar, përveç rasteve të dorëheqjes apo revokimit nga asambleja. Ai është përgjegjës përpara shoqërisë ose të tretëve për shkelje ligjore, për shkelje të statutit ose për gabime të kryera gjatë administrimit.



5. Të ndryshojë Nenin 17 të Statutit, si më poshtë :

KOMPETENCAT E ADMINISTRIMIT DHE PËRGJEGJËSITË

Administratori/ët kujdeset dhe vepron bashkërisht ose veçmas në përputhje me kompetencat si më poshtë vijon :

- Të zbatojë vendimet e ortakut të vetëm.
- Të organizojë punën për përmbushjen e objektit të veprimtarisë së shoqërisë duke relatuar tek ortaku i vetëm për miratimin dhe përmbushjen e tyre.
- Të propozojë për ndryshimin e kapitalit.
- Të miratojë rregullat e brendëshme të shoqërisë dhe të personelit.
- Të drejtojë dhe të kontrollojë veprimtarinë e filialeve, agjensive, përfaqësive dhe zyrave të tjera të themeluara nga shoqëria.
- T'i paraqesë propozime asambesë, për përdorimin e fondeve, shpërndarjen e fitimeve dhe likuidimin e borxheve.
- Administratori/ët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkeljet ligjore të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Klauzolat e Statutit që kufizojnë kompetencat e administratorit duhet të respektohen nga të tretët.
- Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur provon se të tretët e dinin se akti i administratorit i kalon kompetencat e tij, apo objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit, pasojat përkatëse.
- Rregullat e këtij neni nuk zbatohen për marrëveshjet që bëhen për operacionet e përditëshme dhe të kryera në kushte normale.
- Ortaku i Vetëm ka të drejtë që, përveç padisë civile për shpërblimin e dëmit, të kërkojë edhe ndjekjen penale kundër administratorëve.

Shoqëria e mësipërme nuk bën ndryshime të tjera të cilat mbeten ashtu siç kanë qenë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Vendimit Nr. 44, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, të datës, 04.04.2007, çmova se kërkesa e kërkuesit është e drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE;


dhe në bazë të ligjit 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", si dhe të ligjit Nr.7667, datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare",

VENDOSA :

- Pranimin e Kërkesës.
- Depozitimimin në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, të Vendimit Nr. 44, të datës 04.04.2007, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Sh.p.k.
- Urdhërimin e Zyrës së Regjistrimit Tregtar, që të bëjë ndryshimet në kolonat përkatëse.
- Ndaj këtij Vendimi Lejohet ankimi sipas ligji.

Tiranë më 12/04/2007

GJYQTARE

Ullona Zllur


GGIF INVESTIMENTI S.r.l.
Sede Legale: P.zza Kennedy n. 13
60122 ANCONA

P.IVA 0129019 042 8



K O N T R A T E
PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KOFIZUAR

A L B E T O N S S H . P . K .

Palet qe firmosin kete kontrate:

- Ndermarrja shteterore e prodhimit te materialeve te ndertimit N.P.M.N. nr.5, me qender ne rrugen "Ndre Mjeda" Tirane, Shqiperi, e perfaqesuar nga drejtori i saj z.Dhimiter Dervishi.

- Shoqeria GGIF INVESTIMENTI S.r.l. me qender ne Ancona, Itali, e regjistruar ne regjistrin tregtar te Ankones, me numer 20588, e perfaqesuar nga presidenti i saj z.Luigi Fabri, me numer pasaporte 740953E.

Duke u nisur nga fakti se:

N.P.M.N. nr.5 i gjykon te nevojshme investimet e menjehershme, te cilat jane te domosdoshme per rritjen e prodhimit te lendeve te para e te produkteve te gatshme, gjysme te gatshme, te permiresimit gradual te strukturave ekzistuese me teknologji bashkekohore, sidomos ne kete periudhe te vegante te ndryshimeve ekonomike, duke pasur si synim edhe ruajtjen e vendit te punes dhe pagesen e punetoreve, arriti ne perfundimin se eshte i domosdoshem krijimi i nje shoqerie te perbashket, e cila te kete karakter juridik siç e parashikon legjislacionin shqiptar.


Shoqeria GGIF INVESTIMENTI s.r.l e cila eshte ne gjendje siç do te argumentohet ne vijim, te siguroje ndihme financiare, teknike dhe organizative te tilla qe garantojne nje ripërteritje te plote te prodhimit dhe aktivitetit, vendosin si me poshte:

NENI 1

Krijohet shoqeria me karakter juridik e quajtur Albeton S sh.p.k.

Objektivat e shoqerise do te jene si me poshte :

1. Shfrytezimi i kavave ne lumenj e male dhe perpunimi i inerteve.
 2. Prodhimi i materialeve industriale te ndertimit si brenda dhe jashte territorit shqiptar. Pergatitja dhe shperndarja e llaçit, çimentos dhe konglomerateve bituminoze. Perpunimi i lendeve te drurit, hekur betonit, konstruksioneve metalike, etj..
 3. Blerja apo marrja me qera e truallit per ndertimin e fabrikave, linjave dhe impianteve per prodhimin e materialeve te ndertimit.
 4. Dhenia me qera te treteve e makinerive dhe paisjeve qe ajo disponon.
 5. Zhvillimi i sherbimeve qe kane te bejne me asistencen teknike, projektimin dhe drejtimin e punimeve te kryera.
 6. Ndertimi dhe mirembajtja e ndertesave civile, turistike, kulturore, tregtare e sportive, shteterore apo private, e rrugeve, ujellësave, kanalizimeve, aeroportëve, porteve, digave, ne Shqiperi dhe jashte saj.
- Blerja, shitja dhe marrja me qera e ndertimeve.



(Dervishi)

3

GGIF INVESTIMENTI S.r.l.
Sede Legale: P.zza Kennedy n. 13
60122 ANCONA

P.IVA 0129019 0428

8. Pjesmarrja nepermjet aksioneve apo formave te tjera, ne menyre te drejteperdrejte ose jo ne shoqeri te tjera te cilat zhvillojne aktivitetet te ngjashme apo te njejta me te.

9. Venia ne dispozicion e teknologjise se saj ne sektore te prodhimit dhe aktivitetit.

10. Zhvillimi i aktiviteteve financiare qe kane lidhje me objektivat e shoqerise.

Shoqeria do e kete qendren ne Tirane, ne rrugen Ndre Mjeda dhe do te jete subjekt juridik duke filluar qe nga dita e aprovimit te saj nga ana e organeve kompetente, dhe eshte e lire ta kryeje aktivitetin e saj ne Shqiperi apo jashte shtetit.

NENI 2

Shoqeria vepron ne baze te dispozitave ligjore shqiptare, sipas kontrates dhe statutit bashkangjitur asaj.

NENI 3

Kapitali i shoqerise eshte 567.980 USD nga te cilat 227.192 USD perbehet nga ndertesat, makinat, mjetet dhe makinerite e N.F.M.N. NR.5 dhe 340.788 USD nga paisjet, makineri te reja dhe te tjera fonde ne te ardhura, nga ana e shoqerise GGIF Investimenti.

NENI 4

Shoqeria GGIF Investimenti s.r.l. merr persiper qe brenda tre muajve nga dita e miratimit te krijimit te saj, te beje investimin prej 100.000 USD, te cilet do te konkretizohen nga Keshilli Administrativ i shoqerise.

Brenda gjashte muajve merr persiper te beje investimin prej 100.000 USD te tjere me te njejten menyre shfrytezimi.

Brenda nje viti merr persiper te beje investime te tjera prej 140.788 USD. Venia ne shfrytezim e kapitalit te huaj dhe menyra e sjelljes se kapitalit te huaj do te behet me miratimin e te dy paleve.

Derdhja do te behet ne llogarine rrjedhese ne Banken Italo-Shqiptare.

NENI 5

Te gjitha normat qe rregullojne raportet mes ortakeve jane te parashikuara ne statut i cili eshte pjese perberese e kontrates. Te dyja keto dokumente jane perpiluar sipas ligjeve shqiptare ne fuqi per shoqerite e perbashketa.

NENI 6

Me qellim qe t'i jape nje shtytje sa me te madhe veprimtarise organizative deri me 31 dhjetor 1994 shoqeria do te drejtohet nga nje Keshill Administrativ, i perbere prej 5 anetaresh, nga te cilet 3 te zgjedhur nga ortaku qe ka vene shumicen e kapitalit dhe 2 nga ortaku i pakices. Keshilli Administrativ i emeruar nga Asamblea e ortakeve, ne mbledhjen e pare, bere sipas rregullave te parashikuara ne statut, do te



9

emeruje Presidentin i cili zgjidhet nga anetaret e Keshillit dhe Drejtorin e pergjithshem i cili edhe mund te mos jete anetar i Keshillit.

NENI 7

Ortaku qe nuk depoziton kuoten e kapitalit themelor brenda kohes se caktuar ne programin ekonomik, eshte i detyruar te paguaje nje kusht disiplinor qdo dite prej nje te njemjten e shumes se parashikuar.

NENI 8

Te gjitha keqkuptimet qe nuk do te arrijne te zgjidhen me mirekuptim do te zgjidhen nga Gjykata e Kasacionit.

NENI 9

Kjo kontrate eshte bere ne tre kopje ne gjuhen shqipe dhe italiane. Kontratat e te dy gjuheve kane te njejten vlere juridike. Secila nga palet pjesmarrese te shoqerise duhet te ruaje nje kopje origjinale ne te dy gjuhet.

PER N.P.M.N. NR.5
DREJTORI
Z. DHIMITER DERVISHI



Perkthyes: FLUTURA LAKNORI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 30.566. prot.


PER GGIF INVESTIMENTI S.r.l.
PRESIDENTI
SIG. LUIGI FABRI

GGIF INVESTIMENTI S.r.l.
Sede Legale: P.zza Kennedy n. 13
60122 ANCONA
P.IVA 0129019 042 8

VERTETIM

Vertetohet firma e perkthyeses Flutura Laknori, e njohur prej meje personalisht e cila perktheu tekstin sa me siper njelloj me origjinalin nga italishtja ne shqip dhe nenshkroi para meje.


TIRANE 14.9.93.....



Notere
MIMOZA SADUSHI

GGIF INVESTIMENTI S.r.l.
Sede Legale: P.zza Kennedy n. 13
60122 ANCONA

P.IVA 0129019 042 8



STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ALBETON 5 SH.P.K.

Palet qe firmosin si me poshte:

Ndermarrja e prodhimit te materialeve te ndertimit N.P.M.N NR.5, me seli ne rrugen "Ndre Mjeda" Tirane, Shqiperi, person juridik shteteror shqiptar, e perfaqesuar nga drejtori i saj Dhimiter Dervishi.

dhe

Shoqeria GGIF Investimenti s.r.l., me seli ne Ankona (Itali), person juridik privat italian, e regjistruar ne regjistrin tregetar te gjykates se Ankones, me numer 20588, e perfaqesuar nga presidenti i saj zoti Luigi Fabri, me numer pasaporte 740953E kane hartuar si me poshte vijon statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te cilet jane marre vesh ta themelojne midis tyre duke firmosur kontraten.

KREU I

FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA,
KOHEZGJATJA

NENI 1
FORMA

Ndermjet nenshkruesve te kontrates eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar, kontraten dhe me dispozitat e ketij statuti.


NENI 2
Emertimi

Emri i shoqerise eshte ALBETON 5 SH.P.K.

NENI 3
Objekti

Objektivat e shoqerise do te jene si me poshte:

1. Enfrytezimi i kavave ne lumenje e ne male dhe perpunimi i inerteve.
2. Prodhimi i materialeve industriale te ndertimit si Brenda territorit shqiptar ashtu dhe jashte tij. Pergatitja dhe



(Dhimiter Dervishi)

shperndarja e llaçit, çimentos, betonit dhe konglomerateve bituminoze, perpunimit te lendes se drurit, hekur betonit e konstruksioneve metalike.

3. Blerja apo marrja me qera e truallit per ndertimin e fabrikave, linjave dhe impianteve per prodhimin e materialeve te ndertimit.

4. Dhenia me qera te treteve e makinerive e paisjeve qe ajo disponon.

5. Zhvillimi i sherbimeve ne lidhje me asistencen teknike, projektimin dhe drejtimin e punimeve te kryera.

6. Ndertimi dhe mirembajtja e ndertesave civile, turistike, kulturore tregetare dhe sportive, qofshin keto shteterore apo private, e rrugeve, ujesjellesave, kanalizimeve, aeroporteve, porteve, digave, ne territorin shqiptar apo jashte tij

7. Blerja, shitja, marrja me qera e ndertimeve.

8. Pjesmarrja nepermjete aksioneve apo formave te tjera, ne menyre direkte ose jo, ne shoqerite e tjera te cilat zhvillojne aktivitate te ngjashme apo te njejta me te.

9. Venia ne dispozicion e teknologjise se saj ne sektorin e prodhimit dhe ne ate te ndertimit.

10. Zhvillimi i aktiviteteve financiare te cilat kane te bejne me objektivat e shoqerise.

NENI 4

Personi juridik.

Personi juridik i shoqerise njihet qe pas regjistrimit te shoqerise ne organet kompetente shteterore shqiptare. Pas kesaj shoqeria mund te filloje te kryeje veprimtarine e saj.

NENI 5

Qendra e Shoqerise

Qendra e shoqerise eshte ne rruga "Ndre mjeda" Tirane. Transferimi i qendres se shoqerise ne nje adrese tjeter behet me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit te shoqerise.

NENI 6

Celja e filialeve dhe perfaqesive.


Shoqeria mund te çele filiale dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe ne shtete te tjera.

Filialet dhe perfaqesite e saj, krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ate te vendeve ku do te ngrihen.

NENI 7

Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar deri me daten 31 Dhjetor 2020 duke filluar nga data e regjistrimit te saj.



7

Kjo periudhe mund te zgjatet tej afatit te mesiperm me miratimin e ortakeve ne menyre unanime.

KREU II
KAPITALI I SHOQERISE, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT

NENI 8

Rritja ose zvogelimi i kapitalit.

P.IVA 0129019 0428

Ortakët nuk kufizohen ne rritjen e kapitalit te shoqerise.

Rritja e kapitalit te shoqerise behet nga Asamblea e Ortakeve me miratimin e shumices se ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar qe zoterojne shumicen e pjeseve te kapitalit te shoqerise.

Ne rast zmadhimi te kapitalit te shoqerise nepermjet shtimit te pjeseve te reja, ortakët kane te drejten e perparesisë ne nenshkrim, proporcionalisht me shumen e pjeseve te tyre.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj. Zvogelimi i kapitalit vendoset nga Asamblea e Ortakeve me miratimin e shumices se ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit te shoqerise. Zvogelimi i kapitalit i prek te gjithë ortakët ne te njejten mase.

NENI 9

Kapitali i shoqerise

Kapitali i shoqerise eshte 567.980 USD. Ai eshte i ndare ne 567.980 pjese me vlere 1 USD secila plotesisht te shlyera.

Kapitali i shoqerise perbehet nga kontributet e meposhteme:

a) Kontributi ne para : 340.788 USD.

Ortaku shqiptar kontribon me shumen prej 0 USD

Ortaku italian kontribon me shumen prej 340.788 USD.

b) Kontributi ne natyre:

Ortaku shqiptar sjell ne shoqeri, se bashku me garancite e nevojshme ligjore pasurine e tij (shih pasqyrat bashkangjitur) me vlere te pergjithshme 227.192 USD.

Ortaku italian nuk kontribon ne natyre.

Kohezgjatja dhe menyra e vendosjes se kontributeve ne natyre caktohen ne kontraten e themelimit dhe pasqyrat bashkangjitur.

NENI 10

Pjeset e kapitalit te shoqerise

Ne baze te kontributeve te lartepermendura:

Ortaku shqiptar merr 40% te barazvlefshme me 227.192 pjese te kapitalit te shoqerise per kontributin e tij.

Ortaku italian merr 60% te barazvlefshme me 340.780 pjese te kapitalit te shoqerise per kontributin e tij.

ICIF INVESTIMENTI S.r.l.
Sede Legale: P.zza Kennedy n. 13
60122 ANCONA



(Blazin Dervis)



Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin e shoqerise nenshkruhen, shlyhen plotesisht dhe shperndahen ndermjet ortakeve sipas nderjes se mesiperme.
Ndarja e fitimit do te behet ne raport me kapitalin e derdhur.

NENI 11

Transferimi i pjeseve te kapitalit.

Pjeset e kapitalit te shoqerise jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, me rruge trashegimie e ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve.

Ne rast se nje ortak deshiron te shese pjese te pjesmarrjes se tij ne kapitalin themeltar te shoqerise, ai duhet te njoftoje Asamblene e Ortakeve me ane te nje letre rekomande, numrin e pjeseve qe deshiron te shese dhe çmimin e çdo pjese.

Ortaket e tjere, pasi ta kene marre njoftimin nga Keshilli Administrativ mund te pranoje blerjen ose heqjen dore prej saj duke njoftuar me shkrim Keshillin Administrativ brenda 30 ditesh.

Pasi shitja te jete kryer, ortaku duhet t'i komunikojte Keshillit Administrativ identitetin e njerit ose disa ortakeve te rinj, te cilet duhet te gezojne zotesi te plote juridike.

KREU III

Te drejtat dhe Detyrat e Ortakeve.

NENI 12

Te drejtat

Ortaket gezojne keto te drejta kryesore:

- Drejtimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me kontraten e themelimit dhe statutin;
- Pjesmarrjen ne rezultatet e çdo forme e sasie te veprimtarise se shoqerise;
- Emerimin e Keshillit Administrativ dhe administrimin e shoqerise.
- Marrjen e te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomiko-tregtare dhe me veprimtarine e shoqerise, si dhe me dokumentet bilancet dhe llogarite ekonomike;
- Paraqitjen e kerkesave, vrejtimeve e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Asamblea e Ortakeve, sipas ketij statuti;
- Transferimin e pjeseve te kapitalit ndermjet tyre ose personave te trete.

NENI 13

Detyrat e ortakeve

Ortaket kane keto detyra kryesore:

- Te derdhin kontributet e tyre per formimin e kapitalit themelor;
- Te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise si dhe administrimin e saj, sipas ketij statuti;

SHIF INVESTIMENTI S.r.l.
Sede Legale: P.zza Kennedy n. 13
60122 ANCONA

P.IVA 01290190428



(Detyruar te Denejsh)

9

- T'i japi shoqerise te dhenat e domosdoshme per çdo objektiv te veprimtarise se saj;
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektit dhe te funksioneve te shoqerise.

KREU IV

Marrja e vendimeve, Administratimi dhe Kontrolli i Shoqerise.

NENI 14

Ortakët dhe Asamblea e Ortakeve

Ortakët e shoqerise perballojne humbjet e saj vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin e shoqerise.

Vendimet merrem nga Asamblea. Cdo ortak merr pjese ne vendimet e Asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Me ushtrimin e te drejtes se tyre per te marre pjese ne vendimet e Asamblese çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje ortak tjetër, nga bashkeshorti ose nga nje person tjetër i zgjedhur dhe i autorizuar prej tij.

NENI 15

Mbledhja e Asamblese

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortake qe zoterojne mbi 1/10 e pjeseve te kapitalit themelor, nga Keshilli Administrativ, nga revizoret kontabel te autorizuar ose nga likuiduesit.

Sipas rendesise se vendimeve, mbledhja e Asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme.

Mbledhja e zakonshme vendos per çeshtje te tilla si: emerimi ose shkarkimi i Keshillit Administrativ, revizoreve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes se fitimit, etj.

Mbledhja e jashtezakonshme vendos per çeshtje te tilla si: ndryshimet e statutit, zvogelimi i kapitalit themelor, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likuidimi i saj, shkrimi i shoqerise te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera.

Koha e mbledhjes se ortakeve nuk duhet te jete ne me pak se 30 dite nga data e komunikimit ortakeve.

NENI 16

Administrimi

Shoqeria administrohet nga nje Keshill Administrativ qe perbehet nga persona qe mund te jene ortake ne shoqeri ose jo. Keshilli Administrativ emerohet per nje peridhe prej 3 vjetesh me te drejte rizgjedhjeje. Ai eshte pergjegjes perpara shoqerise ose te treteve per shkelje ligjore, per shkelje te statutit ose per gabime te kryera gjate administrimit te tij.

C IF INVESTIMENTI S.r.l.
 Sede Legale: P.zza Kennedy n. 13
 60122 ANCONA

P.IVA 0129019 0428



NENI 17
Kompetencat e Keshillit Administrativ

Keshilli Administrativ ka ne kompetence:

- Administrimin e shoqerise.
- Miratimin e planeve dhe llogarive ekonomike periodike;
- Propozimin per ndryshimin e kapitalit;
- Percaktimin e regjimit dhe te kushteve te llogarise ekonomike;
- Miratimin e rregullave te brendshme te shoqerise dhe te personelit;
- Paraqitjen e propozimeve te Asamblese se Ortakeve per perdorimin e fondeve, shperndarjen e fitimeve dhe likuidimin e borxheve;
- Miratimin e njesive te reja strukturore, filiale, perfaqesi;
- Ndarjen e detyrave ndermjet anetareve te Keshillit.

Keshilli Administrativ mblidhet me kerkesen e Presidentit ose te ndonjerit prej anetareve dhe mbledhjet e tij jane te vlefshme kur sigurohet pjesmarrja e shumices se administruesve. Vendimet e Keshillit merren me votimin e shumices se anetareve.

Administrimi i veprimtarise se perditshme te shoqerise, me vendim te Keshillit Administrativ behet nga kryetari ose zevendes kryetari.

NENI 18
Revizoret kontabel te autorizuar

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje grup ekspertesh te autorizuar, i perbere prej 3 vetesh, 2 te zgjedhur nga maxhoranca dhe nje nga minoranca, te emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjidhje nga shumica e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e kapitalit te shoqerise.

Shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi ne rast se kryhet shkelje, verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

KREU V
Vitit financiar, Llogarite Vjetore, Ndarja e fitimeve,
Rezerva e Domosdoshme


NENI 19
Viti financiar, llogarite vjetore

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar do te perfundoje me 31 Dhjetor.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta te hartuara nga Keshilli Administrativ dhe nga kolegji i eksperteve kontabel te autorizuar miratohen nga Asamblea e Ortakeve me shumicen e votave te ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit te shoqerise. Miratimi i dokumbentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

GGIF INVESTIMENTI S.r.l.
gale: P.zza Kennedy n. 13
Sede 60122 ANCONA

P.IVA 0129019 0428



DINENËNËT

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asamblea e ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendëve mbi fitimin.

Fitimi ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit të shoqërisë. Fitimi që do të shpërndahet përbehet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lena menjëherë për fondin rezerve të domosdoshëm si dhe i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

NENI 21

Rezervat e domosdoshme

Shoqëria nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur po të jetë e nevojshme humbjet e vitit të mëparshëm, rezervon një shumë me vlerë të pakten 1/20 të tij, e cila destinohet për formimin e fondit rezerve të domosdoshëm.

KREU VI

Zgjatja e Afatit, Prishja dhe Likuidimi

NENI 22

Zgjatja e afatit

Me perfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij statuti, zgjatja e tij mund të vendoset nga Asamblea me unanimitet.

NENI 23

Prishja

Shoqëria prishet me perfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 7 të këtij statuti, me përjashtim të rasteve kur bëhet zgjatja e afatit sipas nenit 23 të këtij statuti, ose kur ka një prishje të parakohshme për arsye të parashikuara me ligj.

Shoqëria nuk prishet kur njeri prej ortakëve falimenton, bëhet i paafte ose vdes.

NENI 24

Likuidimi

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit, që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asamblea e ortakëve emeron një ose disa likuidues të cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e

GGIF INVESTIMENTI S.R.L.
Sede: -egale: P.zza Kennedy n. 13
60122 ANCONA

P.IVA 0129019 0428

[Handwritten signature]



[Handwritten signature]



12

operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit Asamblea e ortakeve vendos per bilacin financiar perfundimtar, si dhe per mbylljen e procesit te likujdimit.

Fas pagimit te kreditorëve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likujduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve ne perpjestim te njejte me kontributin qe zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

KREU VII Dispozita te fundit

NENI 25 Shderrimi i Shoqerise

Shderrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive ose komandite behet me miratimin unanim te ortakeve.

Shderrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime behet si me siper.

Vendimi merret pasite paraqitet raporti mbi gjendjen e shoqerise nga ana e 3 eksperteve per shderrimin, te zgjedhur nga ortakët.

NENI 26 Mosmarreveshjet

Te gjitha mosmarreveshjet ndermjet ortakeve si dhe ndermjet shoqerise dhe ortakeve qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit te saj do te zgjidhen sic eshte parashikuar ne kontrate.

NENI 27

Ceshtjet qe nuk trajtohen ne kete statut rregullohen sipas legjislacionit perkates shqiptar.


NENI 28

Ky statut eshte hartuar ne 3 kopje ne gjuhen italiane dhe shqiptare, te cilat kane te njejten vlere juridike.

PER N.P.M.N. NR. 5

DREJTORI

DHIMITER DERVISHI



PER SHOQERINE GGIF INVESTIMENTI

PRESIDENTI

LUIGI FABRI

GGIF INVESTIMENTI S.R.L.

Sede Legale: P.zza Kennedy n. 13
60122 ANCONA



STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

KREU I

EMRI – SELIA – OBJEKTI – KOHEZGJATJA

Neni 1 – Eshte formuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar nen perkufizimin “GGIF INVESTIMENTI S.R.L.”


Neni 2 – Selia e shoqerise eshte ne Rome, via Flaminia n.36 (int.14).

Shoqeria me vendim te organit kompetent, mund te krijojë nendegje, agjensi, perfaqesi ne territorin italian dhe jashte tij, si edhe ti mbylle ato.

Adresa e banimit te ortakeve per çdo raport me shoqerine eshte ajo qe rezulton ne librin e ortakeve.

Neni 3 – Shoqeria ka per objekt:

- shkembimin e te mirave dhe sherbimeve me vendet e Europes Lindore dhe ne veçanti me Shqiperine, edhe permes strukturave te K.E.E., permes aktiviteteve te meposhtme:
- promovimin, realizimin dhe administrimin e veprave te karakterit strukturor dhe infrastrukturor, te lidhura veçanarisht me gjendjen e rrugeve dhe veprave te tjera te lidhura me te, impiante te pastrimit higjieno-sanitar dhe eleminim te mbeturinave per te cilat Shoqeria mund te jete promovuese dhe konçesionare;
- perpunimi, analiza dhe programimi i te dhenave per kontrollin ambjental dhe ekologjik te terrenit dhe te ambjentit dhe vleresimin e tij ne sektorin agro-ushqimor, turistik dhe te gjahut, edhe permes ndertimit, istalimit dhe administrimit te veprave, impianteve dhe sistemeve,
- programimi, realizimi dhe administrimi i sherbimeve ne fushen kulturore, rikrijuese dhe sociale, si edhe te kurseve per formimin profesional dhe multidisiplinar,
- perpunimin, analizimin dhe programimin e te dhenave per projektimin industrial dhe teknologjik, per organizimin sipermarres, tekno-ekonomik, administrativ, financiar dhe marketing per zhvillimet teknike ne proçeset prodhuese industriale, artizanale, turistike dhe multisektoriale, edhe permes organizimit dhe administrimit funksional, teknik dhe administrativ te qendrave dhe laboreve te kerkimit, te zhvillimit dhe projektimit dhe realizim, ristrukturim dhe administrim edhe per qendrat ose komplekset industriale, artizanale, tregtare dhe turisticep-hidro-termale;



KREU VIII
KLAUZOLA E ARBITRAZHIT

Neni 25 – Te gjitha mosmarveshjet qe mund te dalin midis ortakeve ose midis disa prej tyre dhe shoqerise, sipas interpretimit, zbatimit dhe efikasitetit te kerij statuti dhe ndryshimeve te mevonshme, si edhe ne pergjithesi, ne lidhje me raportet sociale, do ti kalojne vendimit te nje Kolegji Arbitror te perbere nga aq arbiter sa jane palet te shtuar me dy, neqoftese palet jane numer tek; ose nga aq arbiter sa jane palet shtuar me me nje nqs palet jane numer çift.

Çdo pale do te emeruje nje arbiter; nje ose dy arbitra do te emerohen nga arbitrat e tjere me marveshje te perbashket.

Ne rast mosmarveshje, nje ose dy arbitrat do te emerohen nga Presidenti i Urdherit te Doktoreve Komerciale te Ankones, i cili do te beje edhe emerimin e arbitrave qe palet kane lene jashte emerimet ne afatitn e pesembedhjete diteve nga komunikimi i emerimit te arbitrit te pare.

Kolegji Arbitror i perbere ne kete menyre do te kete seline ne Ankona dhe do te jape vendimin duke gezuar te gjitha te drejtat dhe pa asnje detyrim formal te çfaredolloji brenda tre muajve nga dita e krijimit te tij.

Vendimi i tij do te jete perfundimtar dhe i paapelueshem, duke bere qe palet te bejne zbatimin e tij, nga tani e tutje, pa asnje lloj perjashtimi.

Kolegji do te vendose edhe mbi pagesen e shpenzimeve dhe honoret qe i takojne çdo arbitri, sipas tarifave profesionale te Doktoreve Komercialiste dhe do te vendose gjithashtu se kujt do ti takoje pagesa ketyre shpenzimeve dhe honorareve.

KREU IX
ZGJIDHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 26 – Zgjidhja e shoqerise do te verifikoeht ne rastet e parashikuara nga neni 2497 i Kodit Civil.

Asamblea do te percaktoje menytrat e likujdimi dhe do te emeruje nje ose me shume likujdatore duke vendosur pushtetin e tyre ne perputhje me normat e detyrueshme te vendosura nga ligji.



KREU X
REFERIMI I LIGJIT

Neni 27 – Per gjithçka qe nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, jane te vlefshme dispozitat ligjore ne fuqi.

F.TO LUIGI FABBRI

F.TO CORRADO SABATUCCI Notaio

KJO ESHTË KOPJE KONFORM ORIGINALIT DHE SHTOJCES SE TIJ PAIJUR ME
FIRMAT E PERCAKTURA NE AKTET NOTERIALE.

LESHOHET PER PERDORIM TE PARASHIKUAR NGA LIGJI NE MUNGESË TE
PULLES.

ANKONA 18 NENTOR 2005

F. TO CORRADO SABATUCCI
Notaio
A. Edip
18/10/2005

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
No. 7861 Rep.

Tirane, me 17.07.2006

VERTETIM NENSHKRIMI

Vertetohet firma e perkthyeses Edlira HYSENI, e njohur personalisht prej meje, e cila me deklaroi se perktheu ne shqip njelloj me origjinalin dokumentin e mesiperm dhe une noteria vertetoj nenshkrimin e saj.



NOTERE
RUKO SAKO

DHOMA E NOTERISE
NR. 3611 REP.
NR. 412 KOL.



KONTRATE SHITJE

PER PJESET E KAPITALIT TE ZOTERUARA NGA SHTETI SHQIPTAR NE SHOQERINE ME KAPITAL TE PERBASHKET

“Albeton 5” SH.P.K. Tirane.

Sot, me date 26.07.2005, ditën e martë, përpara meje noterit të Dhomes së Noterise Tirane ARIAN MERKURI, në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit Tirane, hartohet kontrata e shitjes së pjesëve të kapitalit të zotëruara nga Shteti Shqiptar në Shoqëri me Kapital të Përbashkët “Albeton 5” Sh.p.k. Tirane, midis palëve të cilat rane dakort si më poshtë:

Neni 1- Palet.

1.1. Pala shitese: Agjencia Kombëtare e Privatizimit Tirane e përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm i saj Z.Zihni BEQIRAJ.

1.2. Pala blerese: Shoqëria “GGIF Investimenti” s.r.l. Ankona Itali, e përfaqësohet nga Z. Agostino Montillo, lindur në 21.11.1946, banues në Ankona Via Bocconi n.3, Itali, mbajtes i pasaportës Nr. C 650218.

1.3. Palet në këtë kontratë janë madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar dhe deklaruar se lidhin kontratën e shitjes si vijon.

Neni 2 - Objekti i Kontrates.

2.1. Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotave të zotëruara nga shteti në shoqëri “Albeton 5” Sh.p.k Tirane, me vlerë 66.030.018 (gjashtëdhjetë gjashtëmilionetridhjetëmijëetëmbëdhjetë) leke që përfaqëson 39.17 % të kuotave të kapitalit shtetëror në këtë shoqëri. Pjesë e kapitalit shtetëror që shitet dhe që është objekt i kësaj kontrate është edhe sipërfaqja e tokës prej 34 184 (tridhjetekatërmijëenjëqindetëdhjetëkatërm) metra katrorë perkatesish 18908 m² në pjesën e Rr. Fabrika e Qelqit, dhe 15276 m² në pjesën e Rr. Ndre Mjeda, me një vlerë totale prej 58.914.000 (pesëdhjetëetëtmilionenëntëqindekatërmmbëdhjetë mijë) leke.

Vlera e kapitalit shtetëror për shitje është 66.030.018 (gjashtëdhjetëgjashtëmilion e tridhjetëmijëetëmbëdhjetë) leke.

Vleresimi i pjeseve te kapitalit te shoqerise eshte bere ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi nga Eksperti Kontabel e Autorizuar Z. Adriatik Beqiraj, date 07.03.2005.

Shitja e pjeseve te kapitalit shteteror bazohet ne miratimin e Ministrise se Ekonomise me shkrese Nr.9169 Prot., date 26.12.2003.



Neni 3-Çmimi i shitjes

3.1. Çmimi i shitjes se pjeseve te kapitalit te zoteruar nga shteti, ne shoqerine "Albeton 5" Sh.p.k Tirane eshte 66.030.018 (gjashtedhjetegjashtemilion e tridhjetemijeetetembedhjte) leke, vlere e paguar plotesisht nga pala blerese ne Banken Italo Shqiptare, ne Numrin e llogarise 4302 (Dega e Thesarit) ne favor te Agjencise Kombetare te Privatizimit.

3.2. Pala shitesese deklaron se ne favor te saj eshte derdhur e gjithë shuma e percaktuar ne piken 3.1 te ketij neni para perpilimit te kesaj kontrate, sipas Urdher pageses date 30.06.2005, per shumen 13.203.004 (trembedhjemilion edyqindetreemijeekater) leke leshuar nga Banka Italo Shqiptare, Urdher pagese e dates 01.07.2005, per shumen 52.821.014 (pesedhjeteedymilion e teteqindenjeteemijeekatermbedhjte) leke leshuar nga Banka Italo Shqiptare. dhe Mandaat pagese Nr. Reference 00065 date 14.07.2005 per shumen 6000 (gjashtemije) leke leshuar nga Fraiffeisen BANK.

Vlefte totale e paguar nga pala blerese eshte 66.030.018 (gjashtedhjetegjashtemilionetridhjetemijeetetembedhjte) leke.

Neni 4 – Kushtet e shitjes

4.1. Pjesa e kapitalit te zoteruar nga shteti qe shitet eshte pershkruar ne menyre korrekte ne perputhje me dokumentacionin derguar Agjencise Kombetare te Privatizimit nga Ministria e Ekonomise me shkresen Nr.1684/1 Prot. date 14.04.2005 perpara perpilimit te kesaj kontrate.

4.2. Pala blerese ka plotesuar te gjitha kushtet e percaktuara nga pala shitesese ne autorizimin Nr.2893 Prot., date 30.06.2005 te Agjencise Kombetare te Privatizimit Tirane.

4.3. Pala shitesese garanton bleresin se kapitali, objekt i kesaj kontrate eshte i lire nga çdo detyrim apo barre ligjore, detyrim apo kerkese ndaj çdo personi te trete (publik apo privat).

4.4. Pala blerese pas nenshkrimt te kesaj kontrate, noterimit te saj dhe pas regjistrimit te pasurise ne Zyren e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme te Rrethit Tirane eshte pergjegjese per te gjitha detyrimet ligjore ndaj shtetit qe kane lindur dhe mund te lindin ne lidhje me kete pasuri qe nga momenti i firmosjes se kesaj kontrate.

Pas firmosjes se kesaj kontrate dhe noterimit te saj, pronesia e pjeseve te kapitalit transferohet nga ortakut shteteror tek Shoqeria "GGIF Investimenti" s.r.l Ankona Itall perfaqesuar nga Z Agostino Montillo ne perputhje me objektin e kesaj kontrate



Neni 5 - Te drejtat dhe detyrimet e bleresit

5.1. Bleresi fiton te drejten e pronesise mbi pjeset e kapitalit shteteror te blera prej tij pas firmosjes se kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin perkates.

5.2. Bleresi eshte pergjegjes per te mbuluar te gjitha shpenzimet ligjore dhe te noterise ne lidhje me regjistrimin e kesaj shitjeje. Bleresi eshte pergjegjes per transferimin e titullit te pronesise ne emer te vet.

5.3. Pas nenshkrimit te kesaj kontrate, brenda 30-diteve, ne baze te ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994 "Per regjistrimin e pasurive te paluajtshme" dhe akteve ligjore te dala mbas ketij Ligji, pala blerese eshte e detyruar te paraqitet ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme te Rrethit Tirane. Ne te kundert, ne baze te nenit 12 te ketij ligji me kalimin e ketij afati detyrohet te paguaje nje gjobe ditore prej 10% te vleres se regjistrimit per çdo dite vonese.

Neni 6 - Baza ligjore per lidhjen e kontrates

- Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
- Ligji Nr. 7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit".
- Ligji Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".
- VKM Nr. 230, date 04.04.1998 "Per privatizimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga shteti ne shoqerite me kapital te perbashket".
- VKM Nr. 21, date 21.01.1999 "Per disa ndryshime e shtesa ne VKM nr 230 date 4.4.1998 "Per privatizimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga shteti ne shoqerite me kapital te perbashket".
- Udhezimi Nr. 2/1, date 16.06.1998 "Per zbatimin e VKM nr 230 date 4.04.1998 "Per privatizimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga shteti ne shoqerite me kapital te perbashket".
- Udhezimi Nr. 1, date 01.03.1999 "Per zbatimin e VKM nr 21 date 21.01.1999"
- Udhezimi Nr. 1/1 date 02.11.2000 "Per disa ndryshime ne Udhezimin nr 1 date 1.03.1999".

Neni 7 - Dokumentat ligjore qe i bashkengjiten kesaj kontrate

7.1. Shkresa Nr. 7557/1 date 26.01.2005 e Ministrise se Ekonomise per percaktimin e çmimit te trualtit per shoqerine "Albeton 5" Sh.p.k Tirane.

7.2. Genplanet e shoqerise "Albeton 5" Sh.p.k Tirane.

7.3. Raporti i vleresimit te pjeseve te kapitalit te zoteruar nga shteti ne Shoqerine "Albeton 5" sh.p.k Tirane, pergatitur nga eksperti kontabel i autorizuar Z. Adriatik Beqiraj date 07.03.2005 me tete flete origjinal.

7.4. Shkresa e Ministrise se Ekonomise Nr. 9169 Prot., date 26.12.2003. "Miratim per privatizimin e pjeses se kapitalit shteteror ne shoqerite me kapital te perbashket" me nje flete origjinal.

7.5. Autorizimi i AKP. Nr.2893 Prot., date 30.06.2005 me tre flete origjinal.

7.6. Shkresa e Ministrise se Ekonomise Nr.1684/1 Prot., date 14.04.2005 derguar Agjensise Kombetare te Privatizimit me tre flete origjinal.

7.7. Harta treguese e shoqerise "Albeton 5" sh.p.k Tirane me shkresen Nr. 1276/1 Prot., date 02.06.2005 nga Zyra e Rregjistrimit te Pasurise se Paluajtshme Tirane.


7.8 . Urdher pagesen e dates 30.06.2005, per shumen 13.203.004 (trembedhjete milionedyqindetreemijeekater) leke leshuar nga Banka Italo Shqiptare dhe Urdher pagasa e dates 01.07.2005, per shumen 52.821.014 (pesedhjetedymilione teteqindenjzetemijeekatermbedhjete) leke leshuar nga Banka Italo Shqiptare, dhe Mandat pagese Nr.Reference 00065 date 14.07.2005, per shumen 6000 (gjashtemije) leke leshuar nga Raiffeisen BANK.

Neni 8 – Te ndryshme

8.1. Pala shitesse pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te saj te lire e te plote dhe po keshtu pala blerese pasi e kuptoi permbajtjen e gjeti sipas vullnetit te saj te lire e te plote e nenshkruan kontraten ne pranine e noterit pa asnje pretendim.Kjo kontrate shitje, me kerkesen e paleve perpilohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe me vlere te barabarte. Kontrata perbehet nga 4 (kater) flete. Nje kopje e kontrates qendron ne Zyren e Noteres, nje kopje ne arshiven e Agjensise Kombetare te Privatizimit, nje kopje Zyra e Rregjistrimit e Pasurive te Paluajtshme nje kopje Ministrise se Ekonomise, dhe nje kopje pala blerese. Une noteri, ne baze te Ligjit Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine" si dhe legjislacionit perkates per shitjen e pjeseve te kapitalit shteteror e vertetoj ate sipas ligjit.

PALA SHITSESE

Zihni BEQIRAJ


Drejtor I Pergjithshem




PALA BLERESE

"GGIF Investimenti" s.r.l Ankona

perfaqesuar

nga Z. Agostino MONTILLO



NOTERI
ARIAN MERKURI



160

Nderrmarje e Përbashkët

Albeton 5 Sh.p.k.

MBLEDHJE E ASAMBLESE SE ORTAKEVE NR 16 ME 15 TETOR 1998

Me 15 tetor 1998 ne oren 17.25 ne vazhdim te thirrjes me nr protokolli 110 me daten 11/09/98 e shoqeruar me vone me letren nr 113 te dates 29/09/98 prane qendres se shoqerise "Albeton 5" sh.p.k. ne rrugen Ndre Mjeda u mbledh Asamblea e Ortakeve per te diskutuar dhe zgjidhur pikat e meposhteme te rendit te dites:

1. Eksaminim i raportit te eksperteve per privatizim.
2. Ratifikim i detyres se ekspertit te autorizuar per verifikimin e kapitalit shoqeror dhe per paraqitjen ne Gjykate.
3. Te ndryshme.

Jane presente ing. Luigi Fabri (President) perfaqesues i GGIF Investimenti dhe ing. Bardhyl Bejo, perfaqesues i Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit. Jane gjithashtu prezente keshilltari Dott. Enrico Iuliani dhe ekspertet kontabel te autorizuar per privatizimin, Dott. Mimoza Sula dhe Prof. Peri Buzah, Drejtor Administrativ i Albeton 5 sh.p.k. Prof. Sotiraq Dhamo dhe znj. Majlinda Nikolla si perkthyes e kesaj mbledhjeje.

Presidenti, ne prani te gjithë pjesemarrësve te Shoqerise, hapi diskutimin me pikat e rendit te dites dhe ia jep fjalen Dott. Iulianit qe te zhvilloje funksionet e mbledhjes dhe te permbajtjes se diskutimit.

Ne propozim te pikes se pare te rendit te dites, Presidenti fton ekspertet kontabel per te paraqitur raportin e pregatitur nga vete ata dhe te dorezuar Ortakeve me thirrjen e Asamblese. Ekspertet ilustrone punen e zhvilluar duke nenvizuar qe llogarite e shoqerise dhe gjendja e pasurise jane te verteta dhe pergjigjen me normativat e parashikuara nga ligji, ne konforme te nje Keshilli Administrativ serioz dhe te kujdesshem. Pas relacionit te eksperteve Presidenti hap diskutimin, gjate te ciles del nje gabim ne llogaritje i paraqitur ne raport nga ekspertet, qe i perket vleres nga fondi i tatimeve te vecuara ne baze te ligjit qe lejon ndermarjet e prodhimit qe te mos derdhen taksat mbi fitimin ne 4 vitet e para te aktivitetit. Ky fond ne raport eshte paraqitur me shumen prej 7.164.198 leke, e gjitha kjo 796.946 lek jane relative me fondin e vecuar per humbjet mbi kembimet: vlera korrekte e fondit te taksave e vecuar eshte 6.367.252 leke.

Asamblea fton ekspertet qe te ratifikojne raportin e tyre per te dhene llogari per keto verejtje, qe ekspertet i quajne te vlefshme.

*Inerte - Beton - Celik per Ndertime - Konstruksione Metalike
Rruga Ndre Mjeda - Tirane Tel. 0035542 26485*



Nderrmarje e Përbashkët

Albeton 5 S.k.p.k.

Ing. Bejo ben te ditur qe vlera e ndermarjes e paraqitur ne raportin e ekspertave, per shkak te shvleresimit te lekut, eshte me e vogel se ne momentin e themelimit dhe i kerkon shpjegime ekspertave. Dy ekspertat shpjegojne qe ku eshte nje fakt i paevitueshem per shvlersimin e lekut dhe per legjislacionin kontabel qe parashikon qe te gjithë llogarite te jene te shprehura ne valute kombetare, keshtu qe vlera e kapitalit shoqeror nuk mund te jete e shprehur ndryshe por vetem ne lek.

Ne propozim te pikes nr 2 Asamblea ratifikon detyren e ngarkuar ekspertit kontabel te autorizuar, Prof. Peri Buzali, per verifikimin e kapitalit shoqeror ne lek dhe ne USD. Pas ilustrimit te raportit pune kjo e bere nga Prof. Peri Buzali, Asamblea e konsideron te vlefshme sipas normativave ligjore, dhe vendosi qe te komunikojë ne Gjykate vleren e sakte te kapitalit shoqeror e barabarte kjo me shume prej 75.043.512 leke.

Ne propozim te pikes nr 3 Ing Bejo ben te ditur qe eshte dakort mbi emerimin e Keshillit Administrativ eksistues, te emeruar nga Asamblea para emerimit te perfaqesuesit te palet shteterore.

Duke mos patur argumenta te tjera per tu diskutuar, Presidenti shperndan mbledhjen ne ora 19.15.

Tirane me 16/10/98

Lexuar, firmosur, dhe nenshkruar.

Ing. Luig FABRI

Ing. Bardhyl BEJO

Tirane, më 21.12.1998

Nr. 1052 Rep.


Nr. 372 Kol.

V E R T E T I M

- ti besojne likujdimin e shoqerise nje likujdatori ne personin e z.MONTILLO AGOSTINO, lindur ne Ortona (CH) me 21 nentor 1946, banues ne Ancona (AN), Via Bocconi n.3, kod fiskal: MNT GTN 46S21 G141N, banues per kete detyre prane selise se poshteshenuar te likujdimit,
- ti japin likujduesit te emeruar çdo te drejte qe i jep ligji ne perdorimin e nenshkrimit.

Duke qene se si me siper u vendos venia ne likujdim e shoqerise, Presidenti hedh ne votim piken e trete dhe te fundit te rendit te dites rreth tranferimit te selise qendrore.

Ortaket e GPL COSTRUZIONI GENERALI SRL e FIDICIARIA MARCHE SRL SOCIETA' FIDUCIARIA E DI REVISIONE qe se bashku zoterojne 90% te kapitalit themeltar dhe me voten kunder te ortakut Termentini Patrizia zoteruese e 10% te kapitalit themeltar, vendosen:

- te transferojne seline nga Ancona Fraz. Aspigo n. 116/A ne Rome Via Flaminia n.36 (int.14) ku vendoset selia e likujdimit;
- si rrjedhim te modifikoje pjesen e pare te nenit 2 te statutit qe merr forme si me poshte. "Neni 2 – Selia qendrore e shoqerise eshte ne Roma, Via Flaminia n. 36 (int.14)".

Duke qene se si me sipër u vendos transferimi i selise qendrore, me jipet mua, Noterit, leximi perpara perfaqesuesit dhe asamblese i gjithë teksti i perpunuar i Statutit Social qe i bashkengjitet ketij dokumenti si "A".

Presidentit i jepet e drejta qe ti shtojë ketij akti dhe statutit bashkengjitur te gjitha shtesat, ndryshimet ose heqjet qe mund te kerkohen nga Autoritetet kompetente ne seline e regjistrimit ne Rregjistrin e Ndermarrjeve.

Duke mos patur vendime te tjera per te marre dhe duke qene qe nuk kishte me pyetje, asamblea mbyllet ne oren trembedhjete.

Me kerkesen time, une Noteri kam marre kete akt te shkruar nga personi i besuar nga une ne makine shkrimi, siç eshte parashikuar nga ligji dhe nje pjese nga dora ime dhe lexuar nga une perfaqesuesit, i cili me kerkesen time e ka miratuar duke deklaruar qe eshte konform se vertetes.

Ze pese faqe dhe nje pjese te se gjashtes ne dy flete.

F.TO LUIGI FABBRI

F.TO CORRADO SANTUCCI Noter

ZYRA E RREGJSITRIMIT TE NDERMARRJEVE ANKONA DEPOSITA

PROT. 18443 DATE 29 SHTATOR 2003

ZYRA E RREGJSITRIMIT TE NDERMARRJEVE ROMA DEPOSITA

PROT. 212618 DATE 17 NENTOR 2003



MARRËVESHJE PRIVATE E VËRTETIMIT

Sot më datë 18.03 2006, në Tiranë, përpara meje Noteres Ruko Soda
u paraqitën palët e mëposhtme, për identitetin e të cilëve unë jam e sigurt:

- **GGIF INVESTIMENTI S.r.l.** (këtej e tutje referuar shkurt "Shitësi"), shoqëri e së drejtës italiane në likuidim vullnetar, me seli në Ancona, (Itali) Fraz. Aspigo nr. 116/A, regjistruar pranë Regjistrat të Shoqërive të Ankonës me kod fiskal nr. 01290190428, përfaqësuar nga Z. Bernardino Apicella, avokat dhe qytetar italian, lindur në Salerno, më 23.04.1969, mbajtës i pasaportës me nr. 311500R, në bazë të mandatit të dhënë sipas nenit 4.1 të Kontratës për Shitjen e Pjesëve të Kapitalit nënshkruar më datë 24.02.2006 përpara noterit _____

- nga njëra anë -

dhe

- **Z. Artan DULAKU**, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 30.05.1965, banues në Tiranë, Rr. Pjetër Bogdani, mbajtës i pasaportës me nr. Z0031648 (këtej e tutje referuar shkurt "Blerësi" dhe bashkë me Shitësin referuar edhe si "Palët").

- nga ana tjetër -

Meqë

- Në datën 24.02.2006 ndërmjet Palëve është nënshkruar një kontratë (këtej e tutje referuar si "**Kontrata e Shitjes**") për shitjen e pjesëve të kapitalit (këtej e tutje referuar si "**Pjesët e Kapitalit**") që i korrespondojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë ALBETON 5 Sh.p.k. (këtej e tutje referuar si "**Shoqëria**"), shoqëri e së drejtës shqiptare me seli në Tiranë, Rr. Ndre Mjeda, regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 0754, kod fiskal nr. 030786, NIPT J61817008G;
- Kontrata e Shitjes ia nënshtron transferimin e pronësisë mbi Pjesët e Kapitalit verifikimit të një sërë kushteve pezulluese;
- Palët kanë për qëllim të dëshmojnë në mënyrë të pakundërshtueshme vërtetimin e këtyre kushteve pezulluese me qëllim që të transferohet pronësia e pjesëve të kapitalit nga Shitësi tek Blerësi sipas Kontratës.

Palët deklarojnë e bien dakort se

Blerësi ka përmbushur në mënyrë korrekte dhe sa parashikohet në nenin 2.2 të Kontratës së Shitjes, dhe për pasojë, kushti pezullues i parashikuar në nenin 3 të Kontratës së Shitjes është vërtetuar. Si pasojë e vërtetimit të kushtit pezullues, Kontrata e Shitjes merr fuqi ligjore dhe

Blerësi mund të bëhet pronar i Pjesëve të Kapitalit në mënyrë retroaktive, domethënë duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës.

Unë, Noteri ia lexova këtë marrëveshje private Palëve, të cilat deklaruan se është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Kjo marrëveshje private nënshkruhet nga Palët në praninë time, dhe unë Noteri vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.




Tiranë, 18.03.2006


GGIF INVESTIMENTI S.R.L. (Shitësi):


Artan DULAKU (Blerësi)


NOTERE:

PËRKTHYESE:


BENARD NO APICOLLU


Artan Dulaku


Zuko S. S. S. S.


Ardita Pelinku



G.G.I.F INVESTIMENTI SRL

P.Iva 01290190428

Verbalet e Asambleve te Ortakeve

G.G.I.F. Investimenti SRL ne likuidim

Regj. Imp. 01290190428

Rea

211669

Dr. Prok. Corrado Sabatucci - NOTER
C.so Stamira, 24 – Tel. 2074919 – Fax 205219
60122 Ancona

G.G.I.F. Investimenti S.R.L. ne Likuidim
Me adrese ne Corso Stamira, N. 10 – 60122 Ancona
Kapitali social Euro 464.810 i.v.
Kod Fiskal: 01290190428

Verbali i asamblese se zakonshme
Importet e pranishme jane te shprehura ne Euro.

Me date 30.03.2006, ne oren 15.00, selise sociale qe ndodhet ne ancona,
Corso Stamira, 10 eshte mbajtur asambleja e zakonshme e G.G.I.F.
Investimenti S.R.L. ne likuidim per te diskutuar dhe leshuar kete

Urdher te dites

1. Kominikime te likuiduesit ne lidhje me vazhdueshmerine e aktivitetit te likuidimit DISMISSIONE te kuatave te pjesmarrjes te mbajtura ne kapitalin e Shoqerive te huaja;
2. Vendosjen e shperblimit te likuiduesit.

Ne baze te Statutit, e gjithesesi nen caktimin e plote te te pranishmeve,
ASSOMA presidencen e Asamblese, liquidatori, Z. Agostino Montillo, i cili
veren:

- thirrjen e rregullt te asamblese me lajmerimin e thirrjes te komunikuar TEMPESTIVAMENTE ne baze te ligjeve te Statutit me Poste Rakomande;
- pranine e 90% (nentedhjete perqind) te kapitalit social te sjelle per:
- 20% (njetzet perqind) nga "GPL – COSTRUZIONI GENERALI S.R.L." me seli ne Ancona Via Fioretti, 14 C.F. 00720610427, me ante te te deleguarit Inxh. Luigi Fabri, te pajisur te procure te posacme,
- 70% (shtatedhjete perqind) nga "FIDUCIARIA MARCHE – S.R.L.- Societa Fiduciaria e di Revisione", me seli ne ancona Via Martiri della Resistenza, 7 C.F. 00181780420 me pranine e Keshilltarit te Deleguar Pietro Giugliarelli, e cila merr pjese ne kete akt, me rastin e aktivitetit FIDUCIARIA te kryer ne baze e nen efekt te Ligjit 1966/1939 GIUSTA Autorizimi Ministror D.M. i 2.10.1973 publikuar ne Gazeten Zyrtare nr. 262 te 10.10.1973;
- pranine e likuiduesit te vetem;



- pranine e Kolegjit Sindakal me ane te kryetarit te bashkise Cinzia Luminari, mungojne por jane te justifikuar Presidenti Flavio Guidi dhe Kryetari efektiv i bashkise Odo Scalpelli,

deklaron kete asamble te perbere vlefshmerisht, e per kete te ATTA e te vlefshme per te diskutuar dhe vendosur mbi urdherin e dites te siperpermendur, nese nuk ka kundershite.

Caktohet si Sekretar me vendim unanim te asamblese, Dr.sha Cinzia Luminari, e cila pranon.

Prokurat merren ne akte dhe i bashkalidhen ketij verballi.

Pra kalohet ne urdherin e dites.

Merr fjalen Likuiduesi, i cili, ne lidhje me piken e pare te vene ne urdher te dites, relacionon pjesemarresit ne lidhje me gjendjen e operacionit te leshmit te kuotave pjesemarrese te mbajtura ne Shoqerine e te drejtave shqiptare Albeton 5 Sh.p.k.

Vecanerisht likuiduesi referon se Ka Zbatuar Operacionin E Leshimit???? te ketyre kuotave sociale, dhe i ka efektuar ne baze te fuqive qe I jane dhene sipas art. 18 te statutit Social dhe te art. 2489 etj te Kodit Civil. Pas disa

traktativash te gjata e komplekse, qe perfunduan me ndihmen e profesionisteve italiane dhe shqiptare, ka qene i mundur perfundimi i shitjes se kuotave pjesemarrese te siperpermendura, me ane te nenshkrimit te aktit

qaril Rep. 991 kol. 393, A ROGITO Noter Mimosa Sadushaj nga Tirana per importin kompleksiv prej € 1.000.000/00 (nje million euro).

Mbetet per t'u vendosur impakti fiskal mbi kete operacion leshimi dhe te vazhdohet ne fazen perfundimtare te aktivitetit te likuidimit, pika mbi te cilat likuidatori duhet t'i referoje asamblese brenda pak kohesh.

Asambleja, pas nje diskutimi te gjere dhe shtjellues me votim te hapur me ngritje duarsh me unanimitet

Vendosi

- te marre parasysh sa eshte paraqitur nga Likuidatori dhe te ratifikoje punen e tij me referim te qarte nenshkrimit e kontrates te 24/02/2006, Rep. 991, kol. 393 A ROGITO Noter Mimosa Sadushaj nga Tirana, per importin kompleksiv prej € 1.000.000/00 (nje milion euro).

Persa I perket argumentit te vene ne pike te dyte te urdherit te dites, Asambleja, me votim te hapur, me ngritje duarsh, unanimisht

Vendosi

Te shtyje cdo vendim ne nje asamble tjeter.

Pas kesaj, pasi nuk ka gje tjeter per t'u shpallur, dhe askush nuk kerkoi fjalen, mbledhja perfundoi ne oren 15.45, me redaktimin, leximin dhe nenshkrimine ketij verballi.

Sekretari

Dr.sha Cinzia Luminari
(firma)

Presidenti

Z. Agostino Mortillo
(firma)

Rregjistri nr. 74706

VERTETIM I EKSTRAKTIT

Vertetoj une i nenshkruari dokt. **CORRADO SABATUCCI**, noter ne Ancona, rregjistruar ne rolin e Kolegjit noterial te Komisaritatit te Ancona-s, qe te dhenat e hedhura me lart , jane plotesisht konform origjinalit, dhe eshte ekstrakt i faqes, nr. 2002/78 te librit te verbalit te Asamblese se Shoqerise " **GGIF INVESTIMENTI S.R.L**", me seli ne **ANCONA , C.SO STAMIRA NR. 10**, rregjistruar ne rregjistrin e ndermarrjes ne Ancona me Kod Fiskal nr. **01290190428**.

Verifikimi i zyres dhe rregjistrin te ndermarrjeve , prane C.C.i.a.a te Ancona-s te 30 maj 2002.

Leshohet per perdorrime ligjore,

Ancona, C.so Stamina nr. 24

Me, 05, Prill, 2006

(Firma, Vula)

PROKURPRIA E REPUBLIKES Prane Gjykates ANCONA

Me perfaqesimin e ministrise se drejtesise , legalizohet firma e dokt.

SABATTUCCI CORRADO
NOTER NE ANCONA

ANCONA ,05.04.2006

Prokurori i republikes
(Firma, vula)




Konsullata e Pergjithshme e Republikes se Shqiperise
Piazza Duomo, 17 - 20121 - Milano

Tel.; Fax: +39.02.86.99.53.96

Tel.: +39.02.86.46.74.23

Milano, me 26.04.2006

Vertetohet se perkthimi eshte konform origjinalit.



KONSULLI

Dritan HILA



KAMERA E TREGTISE , INDUSTRISE, ARTIZATIT, BUJQESISE ANKONA
ZYRA E RREGJISTRIMI TE NDERMARRJEVE

CERTIFIKATE E RREGJISTRIMIT NE SEKSIONIN NORMAL

TE DHENA IDENTIFIKUESE PER NDERRMARRJEN

Kodi fiskal dhe numri i rregjistrimit: 01290190428

i Rregjistrimit te Ndermarrjeve te ANKONES

Data e rregjistrimit: 06/04/2005

Rregjistruar ne seksionin NORMAL

me 06/04/2005

Rregjistruar me numrin e Repertorit Ekonomik Administrativ 171647

Emerimi: GGIF INVESTIMENTI S.R.L.

Forma juridike: SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Selia:

ANKONA (AN) CORSO STRAMIRA, 10 CAP 60100

Themeluar me aktin e dates 25/06/1992

Kohezgjatja e shoqerise:

Data e mbylljes: 31/12/2050

OBJEKTI SOCIAL:

- SHKEMBIMIN E TE MIRAVE DHE SHERBIMEVE ME VENDET E EUROPESE LINDORE DHE NE VEÇANTI ME SHQIPERINE, EDHE PERMES STRUKTURAVE TE K.E.E., PERMES AKTIVITETEVE TE MEPOSHTME:
- PROMOVIMIN, REALIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E VEPRAVE TE KARAKTERIT STRUKTUROE DHE INFRASTRUKTUROR, TE LIDHURA VEÇANARISHT ME GJENDJEN E RRUGEVE DHE VEPRAVE TE TJERA TE LIDHURA ME TE, IMPIANTE TE PASTRIMIT HIGJENO-SANITAR DHE ELEMENIM TE MBETURINAVE PER TE CILAT SHOQERIA MUND TE JETE PROMOVUESE DHE KONÇESIONARE;
- PERPUNIMI, ANALIZA DHE PROGRAMIMI I TE DHENAVE PER KONTROLLIN AMBJENTAL DHE EKOLOGJIK TE TERRENIT DHE TE AMBJENTIT DHE VLERESIMIN E TIJ NE SEKTORIN AGRO-USHQIMOR, TURISTIK DHE TE GJAHUT, EDHE PERMES NDERTIMIT, ISTALIMIT DHE ADMINISTRIMIT TE VEPRAVE, IMPIANTEVE DHE SISTEMEVE,

- PROGRAMIMI, REALIZIMI DHE ADMINISTRIMI I SHERBIMEVE NE FUSHEN KULTURORE, RIKRIJUESE DHE SOCIALE, SI EDHE TE KURSEVE PER FORMIMIN PROFESIONAL DHE MULTIDISCIPLINAR,
- PERPUNIMIN, ANALIZIMIN DHE PROGRAMIMIN E TE DHENAVE PER PROJEKTIMIN INDUSTRIAL DHE TEKNOLOGJIK, PER ORGANIZIMIN SIPERMARRES, TEKNO-EKONOMIK, ADMINISTRATIV, FINANZIAR DHE MARKETING PER ZHVILLIMET TEKNIKE NE PROCESSET PRODHUESE INDUSTRIALE, ARTIZANALE, TURISTIKE DHE MULTISEKTORIALE, EDHE PERMES ORGANIZIMIT DHE ADMINISTRIMIT FUNKSIONAL, TEKNIK DHE ADMINISTRATIV TE QENDRAVE DHE LABORATOREVE TE KERKIMIT, TE ZHVILLIMIT DHE PROJEKTIMIT DHE REALIZIM, RISTRUKTURIM DHE ADMINISTRIM EDHE PER QENDRAT OSE KOMPLEKSET INDUSTRIALE, ARTIZANALE, TREGTARE DHE TURISTICP-HIDRO-TERMALE;
- KRYEJA E OPERACIONEVE TE IMPORTIT DHE TE EKSPORTIT PER LLOGARI TE VETE DHE PER LLOGARI TE TE TRETEVE DHE KOMERCIALIZIMI I LENDEVE TE PARA, PRODHIMEVE TE PERFUNDUARA DHE/OSE GJYSEM TE GATSHME, BUJQESORE, PESHKIMIT, INDUSTRIALE DHE ARTIZANALE DHE PRODHIMEVE USHQIMORE SI NE TERRITORIN KOMBETAR ASHTU EDHE JASHTU TIJ;
- MUND TE KRYEJE BLERJEN, SHITJEN, SHKEMBIMIN, NDERTIMIN DHE RISTRUKTURIMIN E NDERTESAVE CIVILE DHE INDUSTRIALE TE TIPIT TRADICIONAL DHE PREFABRIKAT, ADMINISTRIMIN DIREKT DHE INDIREKT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME DHE TERRENEVE FSHATARAKE DHE URBANE, MARRJEN, KONÇESIONIN, DHENIEN ME QIRA TE NDERTESAVE DHE TE ÇDO TE DREJTE TJETER TOTALE OSE PJESORE, REALE OSE JO MBI PASURINE E PALUAJSHTME.
- SHOQERIA, GJITHASHTU, MUND TE KRYEJE, NE MENYRE TE TILLE QE AKTIVITETET E POSHTESHENUARA TE MOS MARRIN KARAKTER KRYESUES, TE GJITHA OPERACIONET TREGTARE, INDUSTRIALE DHE FINANCIARE, TE LUAJTSHME DHE TE PALUAJTSHME PEFSHIRE DHENIN E DOREZANISE, GARANCISE DHE TE ÇDO LLOJ GARANCIE TJETER EDHE REALE, PER ISTITUTE FINANCIARE, BANKA OSE ENTE EDHE PER LLOGARI TE TE TRETEVE, ÇDOHERE QE DO TE JETE E NEVOJSHME OSE E DOBISHME PER VAZHDIMESINE E OBJEKTIT SOCIAL, PERSHIRE EDHE PJESMARRJEN NE FITIME DHE NE SHOQERI OSE FIRMA TE TJERA ME ÇDO LLOJ OBJEKTI SOCIAL SI DIREKT ASHTU EDHE INDIREKT.

SISTEMI I ADMINISTRIMIT DHE KONTROLLIT

KOLEGJI SINDAKAL:

- Kryetare efektive
numri i pjestareve ne detyre: 3
deri me 11/09/2003
- Kryetare plotesues
Numri i pjestareve ne detyre: 1
deri me 11/09/2003

INFORMACIONE MBI STATUTIN

Te drejta nga statuti:

SHOQERIA ESHTË E ADMINISTRUAR NGA NJË ADMINISTRATOR I VETEM, QË MUND TË ZGJIDHET NGA ORTAKET OSE NGA KESHILLI I ADMINISTRIMIT I PERBERË NGA JO MË PAK SE TRE DERI NË SHTATË ANËTARË, EDHË JO ORTAKË. ADMINISTRATORI I VETEM OSE KESHILLI I ADMINISTRIMIT QENDRON NË DETYRE PËR 3 (TRE) VJET, MË SKADENCE QË KONCIDON MË MBLEDHJEN E ASAMBLESE PËR MIRATIMIN E BILANCIT RELATIV TË VITIT TË FUNDIT TË DETYRES SË TYRE. NË ÇFARËDOLLOJ MOMENTI OSE SIPAS KUSHTETUTES ASAMBLEA MUND TË VENDOSË EMERIMIN E NJË ADMINISTRATORI TË VETEM NË VEND TË KESHILLIT TË ADMINISTRIMIT DHE ANASJELLTAS. NË KËTË RAST ZBATOHEN PËR KESHILLIN E ADMINISTRIMIT TË GJITHA NORMAT E PARASHIKUARA PËR ADMINISTRATORIN E VETEM DHE I TAKOJNË KESHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË GJITHA FUQITË DHE TË DREJTAT QË KY STATUT I JEP ADMINISTRATORIT TË VETEM. ADMINISTRATORI I VETEM OSE KESHILLI I ADMINISTRIMIT KA TË GJITHA TË DREJTAT PËR ADMINISTRIMIN E ZAKONSHËM DHE TË JASHTËZAKONSHËM TË SHOQERISË, MË QËLLIM ARRITJEN E QËLLIMIT SOCIAL, PËRVEC AKTIVITETEVE TË POSHTESHËNUARA DHE ATYRE TË REZERVUARA PËR ASAMBLENE E ORTAKËVE NGA LIGJI. VENDIMET E KESHILLIT TË ADMINISTRIMIT MËRRËN MË SHUMICËN ABSOLUTE. VOTA NUK MUND TË JEPËT MË PERFAQËSTI.

NJË OSE MË SHUMË KESHILLTARË TË ADMINISTRIMIT MUND TI KERKOJNË PRESIDENTIT TË KESHILLIT TË ADMINISTRIMIT TI KALOJË ASAMBLESE SË ORTAKËVE, QË DUHËT TË MBLIDHËT RREGULLISHT, DETYREN E VENDOSJES MBI NJË ARGUMENT TË ÇAKTUAR TË PARASHIKUAR NË RENDIN E DITES.

JANË SHPREHIMISHT TË REZERVUARA PËR ASAMBLENE E ORTAKËVE VENDIMET E MEPOSHTME:

- BLERJE, SHITJE, SHKEMBIM I TË MIRAVE TË PALUAJTSHME, MARRJE E OBLIGACIONEVE KAMBIALE, MARRJA E HUAVE HIPOTEKORE, DHENIA E DOREZANISË DHE GARANCISË, KRYERJA E OPERACIONE AKTIVE OSE PASIVE AFATGJATE.

NË RASTIN E ADMINISTRIMIT KOLEGJIAL, KESHILLI MUND TË EMEROJË NJË OSE MË SHUMË ADMINISTRATORE DELEGATE DUKE I DHËNË FUQI DHE TË DREJTA; DO TË EMEROJË EDHË PRESIDENTIN, NË RASTIN KUR ASAMBLEA NUK E KA BËRË. PERFAQËSIA E SHOQERISË KUNDREJT TË TRETËVE DHE NË GJYKIM I TAKON ADMINISTRATORIT TË VETEM OSE PRESIDENTIT TË KESHILLIT TË ADMINISTRIMIT OSE TË ADMINISTRATOREVE TË DELEGUAR, NEQOFTËSE JANË EMERUAR, NË LIMITËT E DELEGIMIT TË CILËT MUND TË LESHOJNË MANDATE SPECIALE MË KUFIZIMET QË QUAJNË TË NEVOJSHME

DREJTORIT, OSE NJE OSE ME SHUME PROKURATOREVE SI BASHKE ASHTU EDHE TE NDARE, PER AKTE TE VECANTA OSE PER KATEGORI AKTESH.

NDARJA E TE ARDHURAVE DHE E HUMBJEVE MIDIS ORTAKEVE NGA TE ARDHURAT, PA TAKSAT MBI TE ARDHURAT, QE REZULTOJNE NGA BILANCI, DUHET TE HIQET NJE KUOTE KORRESPONDUESE ME TE PAKTEN NJE TE NJEZETEN PJESE TE TYRE, PER TU KALUAR NE FONDIN REZERVE, DERISA KY I FUNDIT TE ARRIJE NJE TE PESTEN E KAPITALIT THEMELTAR. PJESA E MBETUR DO TE NDAHET MIDIS ORTAKEVE NE PORPORCION ME KUOTAT QE ZOTEROJNE. ESHTE E DREJTE E ASAMBLESE SE ZAKONSHME QE MIRATON BILANCIN, TE VENDOSE NJE DESTINACION TJETER TE TE ARDHURAVE, PERVEC RASTEVE TE PARASHIKUARA NGA PARAGRAFI I PARE.

Menyrat e thirrjes, nderhyrjes dhe funksionit te asamblese:
ORTAKET MUND TE PERFAQESOHEN NE ASAMBLE ME KUFIZIME SIPAS KOMES SE KATERT TE NENIT 2372 TE KODIT CIVIL.
PERFAQESIMI DUHET TE JETE I DHENE ME SHKRIM EDHE PERMES NJE DELEGIMI TE THJESHTE NE FUND TE LETRES SE LAJMERIMIN E MBLEDHJES; DOKUMENTET RELATIVE DUHET TE RUHEN NE SHOQERI.
ASAMBLEA E ORTAKEVE THIRRET TE PAKTEN NHE HERE NE VIT, BRENDA 120 (NJEQINDENJEZET) DITE NGA MBYLLJA E VITIT FINANCIAR PER APROVIMIN E BILANCIT. KUR RASTE TE VECANTA E KERKOJNE, ADMINISTRATORI I VETEM OSE PRESIDENTI I KESHILLIT TE ADMINISTRIMIT MUND TE KERKOJNE MBLEDHJEN E ASAMBLESE SE ZAKONSHME PER MIRATIMIN E BILANCIT EDHE PAS MBARIMIT TE AFATIT TE CAKTUAR, JO ME SHUME SE 180 (NJEQINDETETEDHJETE) DITE NGA MBYLLJA E VITIT FINANCIAR; ASAMBLEA DUHET TE MBLIDHET GJITHASHTU KUR BEHET KERKESA NGA ORTAKET QE PERFAQESOJNE TA PAKTEN NJE TE PESTEN E KAPITALIT DHE NE KERKESJE JANE SPECIFIKUAR ÇESHTJET QE DO TE TRAJTOHEN.
ASAMBLEA NE THIRRJEN E PARE ESHTE RREGULLISHT E MBLEDHUR ME PRANINE E ORTAKEVE QE PERBEJNE TE PAKTEN TETEDHJETEPESE-PER-QIND TE KAPITALIT THEMELTAR.
AJO VENDOS ME VOTEN NE FAVOR TE ORTAKEVE QE PERFAQESOJNE SHUMICEN ABSOLUTE TE VOTAVE TE TE PRANISHMEVE. NE RASTIN KUR VENDIMET KANE SI OBJEKT ÇESHTJET E PERCAKTUARA NE NUMRAT 4) DHE 5) TE PARAGRAFIT TE DYTE TE NENIT 2479 TE KODIT CIVIL, EMERIMIN E LIKUJDUESVE DHE KRITERET E ZHVILLIMIT E LIKUJDIMIT, ASAMBLEA ESHTE RREGULLISHT E MBLEDHUR DHE VENDOS NE MENYRE TE VLEFSHMESI NE THIRRJEN E PARE, ASHTU EDHE NE TE DYTEN, ME PRANINE DHE ME VOTEN NE FAVOR TE ORTAKEVE QE PERFAQESOJNE TE PAKTEN TETEDHJETEPESE-PER-QIND TE KAPITALI THEMELTAR.
NE THIRRJEN E DYTE ASAMBLEA E ORTAKEV, DUKE MOS PATUR SI OBJEKT ÇESHTJET E PERCAKTUARA NE NUMRAT 4) DHE 5) TE PARAGRAFIT TE DYTE TE NENIT 2479 TE KODIT CIVIL, EMERIMIN E LIKUJDUESVE DHE

KRITERET E ZHVILIMIT E LIKUJIMIT, VENDOS MBI CESHTJET QE DUHET TE ISHIN TRAJTUAR NE TE PAREN, CILIDO QOFTE KAPITALI I PRANISHEM NE ASAMBLE DHE ME VOTEN NE FAVOR TE ORTAKEVE QE PERFAQESOJNE SHUMICEN E PJESMARRESVE.

Klauzola te parablerjes

ORTAKET QE DUAN TE USHTROJNE TE DREJTEN E PARABLERJES DUHET TA KOMUNIKOJNE KETE SHOQERISE BREND A DHJETE DITEVE NGA DITA E MARRJES SE OFERTES.

ADMINISTRATORI I VETEM OSE PRESIDENTI I KESHILLIT ADMINISTRATIV DO TE INFORMOJE MENJEHERE ORTAKUN TRANFERUES PER KERKESAT E MARRA.

CDO ORTAK MUND TE USHTROJE TE DREJTEN E BLERJES NE PROPORCION TE KUOTAVE DHE MUND TE BLEJE TE GJITHA KUOTAT E OFRUARA NE RAST MUNGESSE TE ORTAKEVE TE TJERE.

NE RASTIN KUR NUMRI I KUOTAVE PER TU TRANSFERUAR ESHT E I PANDASHEM DO TE PROCEDOHEM ME SHORT.

NE RASTIN KUR ORTAKU BLERES NUK ESHT E DAKORT ME CMIMIN E KERKUAR, NE KOMUNIKIMIN NE TE CILIN SHPREH INTERESIN E TIJ PER TE FUTUR, DUHET TE KERKOJE VENDIMIN E KOLEGJIT ARBITROR SIPAS DISPOZITAVE TE NENIT 25 TE KETIJ STATUTI.

KOLEGJI ARBITROR DO TE VENDOSE CMIMIN NE BAZE TE SITUATES EFEKTIVE TE PRONESISE SE SHOQERISE NE MOMENTIN E KALIMIT.

ORTAKU TRANFERUES MUND TI KALOJE TE TRETETEVE KUOTAT PER TE CILAT NUK ESHT E USHTRUAR E DREJTA E PARABLERJES NE KOHEN MAKSIMALE PREJ GJASHTEDHJETE DITE NGA DITA E NISJES SE RAKOMANDATES NE TE CILEN ESHT E SHPREHUR INTERESI I SHITJES.

SHITJA KUNDREJT TE TRETETEVE DUHET TE KRYHET BREND A GJASHTEDHJETE DITEVE NGA MBARIMI I AFATIT TE MESIPERM.

DISPOZITAT E MESIPERME ZBATOHEN EDHE NE RASTET E LENIES PENG DHE UZUFUKTIT.

INFORMACIONE PASURORE DHE FINANCIARE

Kapitali Themeltar ne EURO:

vendosur	464.810,00
nenshkruar	464.810,00
derdhur	464.810,00

AKTIVITETI

Ndermarrja aktualisht nuk zhvillon aktivitet.

TITOLLARET E DETYRAVE OSE KUALIFIKIMET

* MONTILLO AGOSTINO (perfaqesues i shoqerise)
Lindur ne ORTONA (CH) me 21/11/1946
Kod fiskal: MNTG-TN46S21G141N
- LIKUJDUES emeruar me akt date 10/09/2003

* GUIDO FLAVIO
Lindur ne ANCONA (AN) me 15/04/1946
Kod fiskal: GDUFLV46D15A271I
- PRESIDENT I KOLEGJIT SINDAKAL emeruar me akt date 11/09/2000

* LUMINARI CINZIA
Lindur ne ANCONA (AN) me 15/02/1961
Kod fiskal: LMNCNZ61B55C615S
- KRYETAR EFEKTIV emeruar me akt date 11/09/2000

* SCALPELLI ODO
Lindur ne CINGOLI (MC) me 15/01/1964
Kod fiskal: SCLDOO64A15C704E
- KRYETAR EFEKTIV emeruar me akt date 11/09/2000

* VEROLI ENRICO
Lindur ne ANCONA (AN) ME 22/03/1968
Kod fiskal: VRLNRC68C22A271X
KRYETAR PLOTESUES emeruar me akt date 11/09/2000

Kjo çertifikate sjell te dhenat e shkruara ne Rregjister deri ditën e sotme.

DEKLAROHET GJITHASHTU SE NE NGARKIM TE KESAJ FIRME NIK
REZULTON TE KETE ARDHUR NE KETE ZYRE NE PESE VITET E FUNDIT
DEKLARATE FALIMENTIMI LIKUJDIMI ADMINISTRATIV I DETYRUESHEM,
PRANIM I RENE DAKORT APO ADMINISTRIM I KONTROLLUAR.
KJO ÇERTIFIKATE LESHOHET NE MUNGESË TE PULLES SIPAS NORMAVE TE
D.P.R DATE 26/10/1972 N. 642 DHE NDRYSHIMEVE TE MEVONSHME.
PERDORIMI PER QELLIME TE TJERA BIE MBI PERGJEGJESINE PERSONALE
TE PREDORUESIT.

fundi i çertifikates

Angelo...
Angelo...

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
No. 7862 Rep.

Tirane, me 17.07.2006

VERTETIM NENSHKRIMI

Vertetohet firma e perkthyeses Edlira HYSANI, e njohur personalisht prej meje, e cila me deklaroi se perktheu ne shqip njelloj me originalin dokumentin e mesiperm dhe une noteria vertetoi nenshkrimin e saj.

NOTERE
RUKO SAKO



Albeton 5 Sh.p.k.

Debit dhe Kredit Kryesore më 23.02.2006

Pershkrimi	KREDI			DEBI			
	Lekë	Vlera Euro	USD	Pershkrimi	Lekë	Vlera Euro	USD
Financim per GGIF TUFO Shqiperi (marrëveshje datë 19.01.06	45.258.078,00			Financim Dulaku			495.552,26
Edil Al-It për qira		105.851,00	19.000,00	Financim Invest	165.500	9.790,00	
Gjendja e tatimit mbi fitimin 2006	84.000			Financim BIA		512.477,02	
GTS qiraja janar-maj 2006				C/C BIA e pambuluar	2.070.008		4036,99
				KIBE	312.645		
				Vigjilenca 2004	715.700		
				GPL		39.412,90	
				BOGA & ASSOCIATES			1.000,00
				Kapare te tjera Alkatel		5.500,00	
				DIFF tatimi mbi fitimin viti 2005	4.306.624		
Totali i Kredive	45.342.078	105.851	26.500	Totali i Debiveve	7.570.477	567.180	500.589

LISTA E MAKINERIVE ALBETON 5

- n. 1 impiant për prodhimin e betonit me kapacitet 40 m³/ora IME
- n. 2 magazinë për çimento
- n. 1 impiant për frantumimin e inerteve me kapacitet 30 m³/ora
- n. 1 impiant për prodhimin e llaçit
- n. 1 ekskavator me zinxhir FE 20
- n. 1 lopatë me rota gome FR 10 B
- n. 1 lopatë me zinxhir FL 10
- n. 1 lopatë me rota gome Benfra 215
- n. 1 lopatë me rota gome Case 721 B
- n. 8 autobetoniera për transportin e betonit
- n. 1 pompë për betonin e markës Cifa
- n. 1 pompë për betonin e markës Putzmeister
- n. 1 Dumper Perlini T 15 mod. 218
- n. 1 Dumper Perlini T 15 mod. 217 S
- n. 1 gru me rota gome
- n. 2 peshore mekanike prej 60 ton
- n. 1 kamjon Fiat Iveco 35 F8B
- n. 1 kamjon Fiat 625
- n. 1 kamjon Astra BM 21 FE1
- n. 2 ashensor Azzolini
- n. 2 autovetura Fiat Fiorino të mbuluara
- n. 1 gjenerator 3 KW
- n. 1 gjenerator 12 KW
- n. 2 gjenerator 80 KW
- n. 1 kamjon autobot 180 NC
- n. 1 kamjon Franchini
- n. 1 furgon Ford Transit i pajisur me strumentat mekanike
- n. 1 rimorkio

VËRTETIM


Sot, më datë 24.022006, unë e nënshkruara, Znj. Gentiana Koduzi, e bija e Fadilit, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980, banuese në Tiranë, Rr. Kavajës, me pasaportë nr. Z 1347741, vërtetoj se, deklarova se versioni shqip i Kontratës për Shitjen e Pjesëve të Kapitalit dhe anekset e saj janë një përkthim i njëjtë me versionin italisht dhe anasjelltas.

PËRKTHYESE
Gentiana Koduzi
Gentiana Koduzi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 108 Rep.

VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot më datë 24.022006, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres Mimeza Sadushaj u paraqit personalisht Znj. Gentiana Koduzi, e bija e Fadilit, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980, banuese në Tiranë, Rr. Kavajës, me pasaportë nr. Z 1347741, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilës u binda pasi verifikova pasaportën e saj, e cila më deklaroi se versioni shqip i Kontratës për Shitjen e Pjesëve të Kapitalit dhe anekset e saj janë një përkthim i njëjtë me versionin italisht dhe anasjelltas, vërtetim të cilin e nënshkroi përpara meje noteres, me vullnetin e saj të plotë dhe të lirë, dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ Kol.

MARRËVESHJE PRIVATE E VËRTETIMIT

Sot më datë 24.02.2006, në Tiranë, përpara meje Noteres _____, u paraqitën palët e mëposhtme, për identitetin e të cilëve unë jam e sigurt:

- **GGIF INVESTIMENTI S.r.l.** (këtej e tutje referuar shkurt "Shitësi"), shoqëri e së drejtës shqiptare në likuidim vullnetar, me seli në Ancona, (Itali) Fraz. Aspigo nr. 116/A, regjistruar pranë Regjistrat të Shoqërive të Ankonës me kod fiskal nr. 01290190428, [OPCIONI 1: përfaqësuar nga likuidatori i saj Z. Agostino MONTILLO, qytetar italian, lindur në Ortona (CH), më 21.11.1946, banues në Ancona (AN), via Bocconi n.3, mbajtës i pasaportës me nr. C 650218] ose [OPCIONI 2: përfaqësuar nga Z. Berardino Apicella, avokat dhe qytetar italian, lindur në Salerno, më 23.04.1969, mbajtës i pasaportës me nr. 311500R, në bazë të mandatit të dhënë sipas nenit 4.1 të Kontratës për Shitjen e Pjesëve të Kapitalit nënshkruar më datë 24.02.2006 përpara noterit


- nga njëra anë -

dhe


- **Z. Artan DULAKU**, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 30.05.1965, banues në Tiranë, Rr. Pjetër Bogdani / mbajtës i pasaportës me nr. Z0031648 (këtej e tutje referuar shkurt "Blerësi" dhe bashkë me Shitësin referuar edhe si "Palët").

- nga ana tjetër -

Meqë

- Në datën 24.02.2006 ndërmjet Palëve është nënshkruar një kontratë (këtej e tutje referuar si "Kontrata e Shitjes") për shitjen e pjesëve të kapitalit (këtej e tutje referuar si "Pjesët e Kapitalit") që i korrespondojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë ALBETON 5 Sh.p.k. (këtej e tutje referuar si "Shoqëria"), shoqëri e së drejtës shqiptare me seli në Tiranë, Rr. Ndre Mjeda, regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 0754, kod fiskal nr. 030786, NIPT J61817008G;
- Kontrata e Shitjes ia nënshtron transferimin e pronësisë mbi Pjesët e Kapitalit verifikimit të një sërë kushteve pezulluese;
- Palët kanë për qëllim të dëshmojnë në mënyrë të pakundërshtueshme vërtetimin e këtyre kushteve pezulluese me qëllim që të transferohet pronësia e pjesëve të kapitalit nga Shitësi tek Blerësi sipas Kontratës.

Palët deklarojnë e bien dakort se



Blerësi ka përmbushur në mënyrë korrekte dhe sa parashikohet në nenin 2.2 të Kontratës së Shitjes, dhe për pasojë, kushti pezullues i parashikuar në nenin 3 të Kontratës së Shitjes është vërtetuar. Si pasojë e vërtetimit të kushtit pezullues, Kontrata e Shitjes merr fuqi ligjore dhe Blerësi mund të bëhet pronar i Pjesëve të Kapitalit në mënyrë retroaktive, domethënë duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontratës.

Unë, Noteri ia lexova këtë marrëveshje private Palëve, të cilat deklaruan se është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Kjo marrëveshje private nënshkruhet nga Palët në praninë time, dhe unë Noteri vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

Tiranë, 24.02.2006



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 207 REP


VERTETIM

Sot ne daten 28.02.2006 (dymije e gjashte) perpara meje Noteres MIMOZA SADUSHAJ, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane me adrese Rr. " Vaso Pasha" P. 13, u paraqit personalisht Z.ERVIN BANO, madhor me zotesi juridike per te vepruar, Avokate prane Zyres TONUCCI i njohur prej meje personalisht , i cili me paraqiti nje document original qe eshte nje Vendim igjyqtarit te vetem me Nr 6754/10 date 20.09.2005 dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me originalin e paraqitur prej saj.



NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E DREJTËSISË
 ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
 ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
 Adresa Rr: "Jordan Misja" Tiranë

VËRTETIM
 NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR

Vërtetohet se në Regjistrin Hipotekor me Nr. 36 Datë 30 / 08 / 2004 figuron e regjistruar në pronësi të :

EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	PJESA
<u>SHOQERIA</u>	<u>" ALBETON S "</u>	<u>SH. P. K</u>	

Pasuria me Nr 2163 e ndodhur në Zonën Kadastrale 8230 me Sip 16908,0 m²
 në adresën: TRUALL ME SHPIERËTARË 18908 M² (TETEMBE DHJETEM IJË
E NENTE RINA E TETE) NË DSHUR NË RRUGEN "FABRIKA E DELBIT"

Kufizimet e Pasurisë janë :

V _____ L _____
 J _____ P _____

Origjina e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme :

Nr.Hip SHITET, dt _____ / _____ / _____
 Nr.Hip _____, dt _____ / _____ / _____
 Nr.Hip _____, dt _____ / _____ / _____
 Nr.Hip _____, dt _____ / _____ / _____

Barrë mbi pasurinë JASKR. NR. 983 DT. 04.07.2005 (B. I. A)

Komente nga Regjistruesi VERTETIMI ESHTË I VLEFSHEM PER SIP. = 16908 M²
NE BAZE TE KONTRATE SHITJES NR. 36// REP. 412 KOL. DT. 26.07.2005 ME ...
 Ky vërtetim është i vlefshëm i shoqëruar me Hartën Treguese Provizore.

Ky formular miratohet për vërtetimin e pronësisë deri në përfundimin e Regjistrimit Filleshtar sipas Ligjit Nr. 7843, date 13/07/1994

Vërtetimi i pronësisë lëshohet sipas kërkesës
 Nr. 25986/34, dt 08 / 12 / 2005
 paraqitur pranë ZRPP Tiranë

Datë 03 / 02 / 2006

REGJISTRUES
 MAILINDA BOZGO

TE VETEM : MAJLINDA DOGGA ME NR. 6754/10 DT. 20.08.2005
E KAPITALIT SHITET PREJ 39.17% KU PERSHIHET DHE SIPERFAC
TRUALLIT PREJ 18908 M², KALON NE PROMESI TE SHQERISE "GGIF
- STIMENTI", S.R.L. E CILA BEHET PRONARE E 100% TE KAPITALIT TE
SHQERISE "ALBETON S." SH.P.K.

REGJISTRUESI

MAJLINDA DOGGA



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUJAJSHME

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8230 NR. I PASURISE 2/63 VOLUME FOLIO 9

INDEKSI I HARTES TR-ST 1,2 SHKALLA 1:1000

ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE QF TIRANE

REL FABRIKA QERAM Sh K Ap

B. KUFIZIMET

V. 2/455

L. 2/69 2/270 2/27 SHODERIA

J. 2/65

P. ALBETON 59


D. Data: 03/02/2006 Ora:

C. PRONARJET


Shpik



Vula



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 996 REP



VERTETIM

Sot ne daten 28.02.2006 (dymije e gjashte) perpara meje Noteres MIMOZA SADUSHAJ, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane me adrese Rr. " Vaso Pasha" P. 13, u paraqit personalisht Z.ERVIN BANO, madhor me zotesi juridike per te vepruar, Avokate prane Zyres TONUCCI i njohur prej meje personalisht , i cili me paraqiti nje document original qe eshte nje Vertetim pronesie date 03.02.2006 me Nr regjistri hipotekor 36 dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin e paraqitur prej saj.



NOTERE



MIMOZA SADUSHAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E DREJTËSISË
 ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
 ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
 Adresa Rr: "Jordan Misja" Tiranë

VËRTETIM
 NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR

Vërtetohet se në Regjistrin Hipotekor me Nr. 325 Datë 30/08/2004 figuron e regjistruar në pronësi të:

EMRI ATËSIA MBIEMRI PJESA

SHOQERIA

"ALBETON"

5

SH.P.K.

Pasuria me Nr. 2/229 e ndodhur në Zonën Kadastrale B220 me Sip 15.246 m²
 në adresën: TRUALL I NDODHUR NE RREZIN "NORE MTEJA" ME
SIPERFAQE 15.246 M² (pesëmbëdhjetë mijë e dyqinda e
shtatë dhjetë e gjathtë) M²

Kufizimet e Pasurisë janë:

V 2/221; 2/228; 2/226; 2/227 L 2/230; 2/322; 2/230

J 2/230; 2/322; 2/230 P 2/1; 2/193; 2/194

Origjina e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme:

Nr.Hip SHITET, dt

Nr.Hip _____, dt

Nr.Hip _____, dt

Nr.Hip _____, dt

Barrë mbi pasurinë NUK KA

Komente nga Regjistruesi NE BAZË TE KONTRATES SE SHITJES
NR: REP 412 KQ/3611 D.26.07.2005, NOTERI: ARIAN MERKURI DHE
 Ky vërtetim është i vlefshëm i shoqëruar me Hartën Treguese Provizore.

Ky formular miratohet për vërtetimin e pronësisë deri në përfundimin e Regjistrimit Fillestar sipas Ligjit Nr. 7843, date 13/07/1994

Vërtetimi i pronësisë lëshohet sipas kërkesës Nr. 15986/94, dt. 8/12/2005 paraqitur pranë ZRPP Tirane


Datë 26/01/2006

REGJISTRUES

MAJLINDA BOZGO

VENDIMIT TE BJTQITARIT TE VETEM NAJLINDA BOGA MENR: 6
DT: 20/09/2005 PJESA E KAPITALIT SHITET PREJ 39,17% KURBA
DHESIPERFAQJA E TRUALLIT PREJ 15.276 M² KALON NE PRONESI
TE SHODERISE "EGIF INVESTIMENTI" S.V.L ECILA BEHET
PRONARE E 100% TE KAPITALIT TE SHODERISE "ALBETON 5
SH.P.K"

REGJISTRUES
NAJLINDA BOZEO




V.R.P.P.
 ROVIZORE
 TIRANE
 ZYRA E REGJISTRIMIT
 PASURIVE TE PALUJAJSHME

KARTA I REGUISE E REGJISTRIMIT
 (Fraport)



TIRANE

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
 ZONA KADASTRALE 8220 NR. I PASURISE 2/229 Vol. 14 Fol. 10
 INDEKSI I HARTES TR-OP-7.8 SKALJA 1:1000
 ADRESA E PASURISE: Rr. TIRANE QY TIRANE
 Rr. NORE MVEBA P/G - Sh - K - Ap -
 B. KUFIZIMET
 C. PRONARIET
 V. 2/321; 2/228; 2/226; 2/227
 L. 2/230; 2/322; 2/230 ALBERTON 55410
 J. 2/230; 7/15
 P. 2/19; 2/193; 2/194; 2/1 ST = 15276,0 M²
 D. Data: 28/01/2006 Ora: 12



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 885 REP



VERTETIM

Sot ne daten 28.02.2006 (dymije e gjashte) perpara meje Noteres MIMOZA SADUSHAJ, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane me adrese Rr. " Vaso Pasha" P. 13, u paraqit personalisht Z.ERVIN BANO, madhor me zotesi juridike per te vepruar, Avokate prane Zyres TONUCCI i njohur prej meje personalisht , i cili me paraqiti nje document original qe eshte nje Vertetim pronesie date 26.01.2006 me Nr regjistri hipotekor 325 dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin e paraqitur prej saj.

NOTERE



MIMOZA SADUSHAJ



KONTRATË PËR SHITJEN E PJSËVE TË KAPITALIT

Sot më datë 24.02.2006, në Tiranë, përpara meje Noteres M. Savelidze, u paraqitën palët e mëposhtme, për identitetin e të cilëve unë Noteria jam e sigurt:

GGIF INVESTIMENTI S.r.l. (këtej e tutje referuar shkurt "Shitësi"), shoqëri e së drejtës shqiptare në likuidim vullnetar, me seli në Ankona, (Itali) Fraz. Aspio nr. 116/A, regjistruar pranë Regjistrin të Shoqërive të Ankonës me kod fiskal nr. 01290190428, përfaqësuar nga likuidatori i saj Z. Agostino MONTILLO, qytetar italian, lindur në Ortona (CH), më 21.11.1946, banues në Ankona (AN), via Bocconi n.3, mbajtës i pasaportës me nr. C 650218 në bazë të çertifikatës së lëshuar nga Dhoma e Tregëtisë Industrisë Artizanatit dhe Agrikulturës së Ankonës që i bashkëngjitet në një kopje kësaj kontrate si Shtojca 1;

- nga njëra anë -

dhe

Z. Artan DULAKU, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më datë 30.05.1965, banues në Tiranë, Rr. Pjetër Bogdani, mbajtës i pasaportës me nr. Z0031648 (këtej e tutje referuar shkurt "Blerësi" dhe bashkë me Shitësin referuar edhe si "Palët").

- nga ana tjetër -

Meqë

- (a) Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate për Shitjen e Pjesëve të Kapitalit, Shitësi rezulton pronar i pjesëve të kapitalit (këtej e tutje "Pjesët e Kapitalit") që i korrespondojnë 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë **ALBETON 5 Sh.p.k.**, shoqëri e së drejtës shqiptare me seli në Tiranë, Rr. Ndre Mjeda, regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 0754, kod fiskal nr. 030786, NIPT J61817008G (këtej e tutje referuar "Shoqëria");
- (b) Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate për Shitjen e Pjesëve të Kapitalit, Shoqëria rezulton pronare e disa terreneve (këtej e tutje referuar si "Terrenet") me një sipërfaqje totale prej 34.184 m² (tridhjetëekatërmijënjëqindetëdhjetëekatër metra katrorë) dhe më konkretisht:
- të një terreni (këtej e tutje referuar si "Terreni nr. 1") me një sipërfaqje të barabartë me 15.276 m² (pesëmbëdhjetëmijëedyqindeshatëdhjetëegjashtë metra katrorë) ndodhur në Rr. Ndre Mjeda dhe identifikuar si prona me nr. 2/229, zona kadastrale nr. 8220, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 325, datë 30.08.2004, siç tregohet më qartë nga vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit

të Pasurive të Paluajtshme Tirana 1, datë 26.01.2006 që i bashkangjitet kësaj Kontrate si **Shtojca 2**; dhe

2. të një terreni (këtej e tutje referuar si "**Terreni nr. 2**") me një sipërfaqje të barabartë me 18.908 m² (tetëmbëdhjetëmijëenëntëqindetë metra katrorë) ndodhur në Rr. Fabrika Qelqit dhe identifikuar si prona me nr. 2/63, zona kadastrale nr. 8230, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 36, datë 30.08.2004, siç tregohet më qartë nga vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tirana 1, datë 03.02.2006 që i bashkangjitet kësaj Kontrate si **Shtojca 3**.

- (c) Shitësi është bërë pronar i 100% të Pjesëve të Kapitalit të Shoqërisë pas blerjes – mbi bazën e kontratës nr. 3611 Rep., nr. 412 Kol., datë 26.07.2005 dhe vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 6754/10 datë 20.09.2005 – të pjesëve të kapitalit që i korrespondojnë 40% të kapitalit themeltar të Shoqërisë që më parë ishin pronë e Shtetit shqiptar të përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë (këtej e tutje referuar si "**Procedura e Privatizimit**").
- (d) Blerësi dëshiron të blejë dhe Shitësi dëshiron të shesë 100% (njëqind për qind) të Pjesëve të Kapitalit të Shoqërisë në pronësi të Shitësit, sipas kushteve të mëposhtme.

Meqë egzistojnë kushtet paraprake, Palët, me aftësi të plotë për të vepruar dhe me vullnet të lirë, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë Kontratë për Shitjen e Pjesëve të Kapitalit (këtej e tutje referuar si "**Kontrata**") sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1 - Kushtet Paraprake

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

Neni 2 – Blerja e Pjesëve të Kapitalit dhe Pagimi i Çmimit

- 2.1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe me vërtetimin e të gjitha kushteve pezulluese parashikuar në nenin e mëposhtëm 3, Shitësi i shet dhe i transferon Blerësit, i cili deklaron se dëshiron të blejë 100% (njëqind për qind) të Pjesëve të Kapitalit të Shoqërisë pronë e Shitësit, plotësisht të lira nga çdo detyrim në favor të të tretëve, me çmimin prej (këtej e tutje referuar si "**Çmimi**") EURO 1.000.000 (njëmilion/00).
- 2.2. Çmimi do të paguhet nga Blerësi jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kësaj Kontrate nëpërmjet derdhjes në llogarinë bankare rrjedhëse nr. 000002974134 hapur në emër të GGIF Investimenti S.r.l. pranë Banca di Roma, Fil. 6, Via Caduti del Lavoro, Ancona, IBAN: IT71BO300202603000002974134 – SWIFT: BROMITRDANX;
- 2.3. Për sqarim, kjo Kontratë nuk transferon menjëherë pronësinë e Pjesëve të Kapitalit në favor të Blerësit, përderisa kalimi i pronësisë i Pjesëve të Kapitalit kushtëzohet nga realizimi i kushtit pezullues të parashikuar në nenin 3 vijues.

Neni 3 – Kushti Pezulluese

- 3.1. Fitimi i Pronësisë mbi Pjesët e Kapitalit, nga ana e Blerësit, kushtëzohet nga Palët me realizimin e përmbushjes nga ana e Shitësit të detyrimit të pagesës, parashikuar në nenin 2.2 të kësaj Kontrate.

Neni 4 – Realizimi i Kushtit Pezullues

- 4.1 Në rastin e realizimit të kushtit pezullues të parashikuara në nenin 3 të kësaj Kontrate, Palët do të nënshkruajë përpara një noteri një deklaratë të përbashkët (këtëj e tutje referuar si “**Marrëveshje Private e Vërtetimit**”) – që i bashkangjitet kësaj Kontrate si **Shtojca 4**. Marrëveshja Private e Vërtetimit do të dëshmojë realizimin e kushtit pezullues. Në mënyrë alternative, kjo Marrëveshje Private e Vërtetimit mund të nënshkruhet në emër dhe për llogari të Shitësit – nga Z. Berardino APICELLA, avokat dhe qytetar italian, lindur në Salerno, më 23.04.1969, mbajtës i pasaportës me nr. 311500R, të cilit Shitësi i jep që në këtë moment tagra përfaqësimi me qëllim që në emër dhe për llogari të Shitësit të kryejë çdo formalitet të nevojshëm për qëllimet e këtij neni.
- 4.2 Marrëveshja Private e Vërtetimit do të dëshmojë realizimin e kushtit pezullues, dhe, për pasojë blerjen e Pjesëve të Kapitalit nga Blerësi. Efektet e realizimit të kushteve pezulluese do të rrjedhin nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate: me fjalë të tjera, Blerësi duhet të konsiderohet, me të gjitha efektet ligjore, pronar i Pjesëve të Kapitalit nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Palët pranojnë pranojnë se – vetëm pas paraqitjes së kësaj Kontrate sëbashku me Marrëveshjen Private të Vërtetimit – Blerësi do të ketë të drejtën të regjistrojë emrin e tij në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 4.3 Në periudhën e ndërmjetme, nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe datës së vërtetimit të kushtit pezullues parashikuar në nenin 3, Shitësi do të bëjë të mundur që Shoqëria:
- (i) të operojë dhe menaxhohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas kriterëve të administrimit të zakonshëm;
 - (ii) të mos shesë asnjë prej pasurive të saj -- duke përfshirë edhe Terrenet – si dhe të mos krijojë, pa miratimin e shprehur të Blerësit dhe në bazë të parashikimeve të nenit 6.2 në vijim, asnjë barrë, hipotekë, peng mbi pasuritë e saj;
 - (iii) të mos kryejë asnjë akt që mund të rrezikojë gjendjen pasurore të saj apo ndryshojë Llogarinë Debitorë/Kreditorë të përshkruar në Shtojcën 7;
 - (iv) të mos kryejë asnjë akt që nuk është koherent me qëllimet e kësaj Kontrate.

Neni 5 – Mos-Realizimi i Kushtit Pezullues

Në rast të mos-realizimit të kushtit pezullues të parashikuar në nenin 3 të kësaj Kontrate, kjo shitje do të konsiderohet se nuk është kryer dhe Shitësi do të ketë të drejtë të mbajë Blerësit të gjithë shumën e paguar nga ky i fundit.

Neni 6 – Detyrimet dhe Deklarimet e Palëve

- 6.1 Me realizimin e kushtit pezullues të parashikuar në nenin 3, Blerësi do të zëvendësojë Shitësin në të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij dhe në mënyrë të vecantë në të drejtën e ndarjes së fitimeve duke filluar nga viti financiar në vijim dhe në ndarjen e pasurive të shoqërisë, sidhe në detyrimin të përballojë detyrimet dhe pasivet e mundshme, e gjithë kjo në proporcion me pjesët e kapitalit të blera.

- 6.2 Shitësi deklaron dhe garanton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Shoqëria ka titull të plotë dhe ekskluziv pronësie mbi (i) Terrenet (si Terreni nr.1 ashtu edhe Terreni nr.2), (ii) ndërtime të kryera mbi to, dhe (iii) makineritë e përshkruara në **Shtojcën 5** të kësaj Kontrate, dhe se – me përjashtim të një hipoteke të vënë në favor të Bankës Italo Shqiptare (në vijim referuar si “**BIA**”) mbi Terrenin nr. 2 si garanci për një hua të dhënë nga BIA për Shoqërinë, në bazë të një kontrate të nënshkruar në datë 30.06.2005 përpara Noterit Agim Robo, me Rep. nr.9071 dhe Kol. nr. 798, dhe një shtese të mënonëshme nënshkruar në datën 21.09.2005 përpara Noteres Edlira Take, me Rep. nr. 814 dhe Kol. nr. 171 – këto Terrene janë plotësisht të lira nga çdo hipotekë, peng, servitut apo barrë tjetër të çdo natyre në favor të të tretëve.
- 6.3 Palët njohin se nga dokumentacioni aktualisht në dispozicion të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë 1) rezulton se një pjesë e Terrenit nr. 2 (me kufizuese me të, vërtetim që i bashkangjitet kësaj Kontrate si Shtojca 3, e cila është e vlefshme vetëm për 16.908 m². Gjithashtu, Palët njohin se duhet të sqarohet përfundimisht se në zonën e lartpërmendur prej 2000 m² ekzistojnë ose do të ekzistojnë në të ardhmen të drejta të të tretëve dhe për këtë qëllim, Shitësi shpreh disponibilitetin e tij për të bashkëpunuar edhe pas nënshkrimit të kësaj Kontrate sipas modaliteteve që do të përcaktohen në një marrëveshje të posaçme.
- 6.4 Pa rënë ndesh me parashikimet e nenit 6.3. të mësipërm, Shitësi deklaron shprehimisht se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate nuk egziston dhe se nuk është kërcënuar më parë nga asnjë veprim ligjor i ish-pronarëve të Terreneve dhe se, për pasojë, titulli i pronësisë së Shoqërisë mbi këto prona është i plotë dhe absolut me të gjitha efektet ligjore.
- 6.5 Shitësi deklaron se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Shitësi ka titull pronësie të plotë dhe ekskluziv mbi Pjesët e Kapitalit dhe se këto të fundit janë plotësisht të lira nga çdo peng apo barrë tjetër të çdo natyre në favor të të tretëve. Shitësi deklaron shprehimisht se Procedura e Privatizimit është kryer në mënyrë korrekte dhe sipas kushteve ligjore, dhe për pasojë, titulli i pronësisë së Shitësit mbi Pjesët e Kapitalit është i plotë dhe absolut me të gjitha efektet ligjore, siç vërtetohet edhe nga Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6754/10 datë 20.09.2005, një kopje e së cilës i bashkangjitet kësaj Kontrate si **Shtojca 6**.
- 6.6 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria ka paraqitur brenda afateve ligjore, të gjitha deklarimet fiskale, të detyrueshme për tu paraqitur, deri më datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe se Shoqëria ka paguar të gjitha tatimet, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe çdo detyrim tjetër administrativ në lidhje me aktivitetin e kryer nga Shoqëria, pagesa e të cilave ishte e detyrueshme deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 6.7 Palët njohin se pasivet dhe borxhet e Shoqërisë janë vetëm ato të përshkruara në Llogarinë Debitorë/Kreditorë (“**Llogaria Debitor/Kreditor**”) të Shoqërisë, azhornuar në datë 23.02.2006, që i bashkangjiten kësaj Kontrate si **Shtojca 7** dhe se, për pasojë, Shitësi do të përjashtojë dhe do ta mbajë Blerësin të pacënuar nga çdo pasiv tjetër të ardhshëm të Shoqërisë. Me “pasiv të ardhshëm” do të kuptohet çdo detyrim tjetër i Shoqërisë, i papërshkruar në **Shtojcën 7** dhe i lindur – me çdo titull – në një datë që i paraprin datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe që i referohet në mënyrë të qartë dhe të demonstrueshme veprimeve apo mosveprimeve të Shoqërisë apo administratorëve të saj deri në mbylljen e vitit financiar 2004 (për vitet financiare vijuese përgjegjësia i kalon

Blerësit), qoftë ky (detyrimi) lindur ndaj administratës tatimore shqipëtare, sigurimeve shoqërore, të punësuarve të Shoqërisë, kreditorëve ashtu edhe të tretëve në përgjithësi. Për këtë qëllim, Blerësi deklaron se ka analizuar, verifikuar dhe miratuar - drejtpërdrejt apo nëpërmjet konsulentëve të saj - gjendjen pasurore, financiare dhe kontabile të Shoqërisë deri në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe se e pranon si të vërtetë Llogarinë Debitorë/Kreditorë që i bashkangjitet kësaj Kontrate si Shtojca 7.

- 6.8. Shitësi deklaron dhe palët pranojnë se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate një pjesë e Terrenit nr. 2 i është dhënë me qira shoqërisë Alcatel Italia S.p.A – Dega në Shqipëri (këtë e tutje referuar si “Alcatel”), ndërsa një pjesë tjetër e Terrenit nr. 2 rezulton e zënë nga shoqëria GTS Sh.p.k., me NIPT J6190501B, me seli në Rr. Fabrika e Qelqit, Kombinat, Tiranë, (këtë e tutje referuar si “GTS”) në bazë të një marrëveshje verbale me Shitësin. Blerësi deklaron se bie dakort me praninë e Alcatel, se është i informuar mbi afatin e qirasë dhe se ka kontaktuar Alcatel për të rregulluar vazhdimin e raportit, por kërkon asistencën e Shitësit me qëllim që GTS të lirojë pjesën e Terrenit nr. 2 të zënë prej saj. Në këtë pikë, meqenëse Shitësi deklaron dhe garanton se GTS është e gatshme për të liruar pjesën e terrenit të zënë prej saj me kërkesën e Shitësit, Palët bien dakort përsa më poshtë:
- (a) Shitësi do të ofrojë bashkëpunimin e tij dhe do të bëjë ç’është e mundur dhe/ose e dobishme me qëllim që GTS të lirojë brenda datës 30.05.2006 pjesën e terrenit të zënë prej saj;
 - (b) Nëse nuk do të jetë e mundur që të arrihet me mjete miqësore sa parashikohet në paragrafin e mësipërm (a), dhe bëhet e nevojshme ndjekja e një procedure gjyqësore kundër GTS, Shitësi do të ofrojë bashkëpunimin e tij Blerësit duke ndarë me të shpenzimet e mundshme gjyqësore.

Neni 7 – Shpenzimet dhe taksat

Shpenzimet ligjore dhe kontabile, taksat, shpenzimet noteriale ashtu si edhe çfarëdo shpenzimi tjetër që lidhet me këtë Kontratë, do të përballohen në mënyrë të barabartë nga të dyja Palët.

Neni 8 – Trashëgimia dhe cedimi

Kjo Kontratë do të detyrojë Palët dhe do të jetë e vlefshme si ndaj tyre ashtu edhe ndaj trashëgimtarëve të tyre. Asnjëra prej Palëve nuk mund ta cedojë Kontratën pa miratimin me shkrim të Palës tjetër.

Neni 9 – Përmbajtja e kontratës dhe ndryshimet

Ndryshime të mundshme ose shfuqizime të kësaj Kontrate mund të bëhen vetëm me shkrim, të nënshkruhen nga të gjitha Palët dhe t'i bashkëngjiten asaj.

Neni 10 – Ligji i zbatueshëm

Kjo Kontratë dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve do të rregullohen dhe ushtrohen në bazë të së drejtës shqiptare.

Neni 11 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 11.1 Palët bien dakort se të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhen në mënyrë përfundimtare sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregëtisë nga 3 (tre) arbitra të emëruar në përputhje me këtë Rregullore. Selia e arbitrazhit do të jetë në Tiranë (Shqipëri) dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë ajo italiane.
- 11.2 Arbitrat do të marrin vendim në bazë të ligjit dhe vendimi i tyre, i cili do të ketë efekte detyruese ndaj Palëve si shprehje e vullnetit të tyre, nuk do të jetë objekt apelimi apo kundërshtimi.
- 11.3 Pavarësisht nga fillimi i ndonjë procedure arbitrazhi, Palët do të kenë të drejtë të kërkojnë masa paraprake dhe urgente në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në rast se kjo e fundit do të garantojë një mbrojtje më të mirë dhe efikase të të drejtave që lindin nga kjo Kontratë apo të kontratave të tjera të lidhura me këtë.

Neni 12 – Origjinalet

Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën italiane të cilave i është bashkëngjitur versioni shqip, të gjitha të nënshkruar nga palët më datë 24.02.2006. Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me intepretimin ose ekzekutimin e kësaj Kontrate, versioni italian do të jetë i vetmi version me efekt juridik provues për palët.

* * *


I bashkangjiten kësaj Kontrate dhe përbëjnë pjesë integrale të saj:

- Shtojca 1:** Certifikata e shoqërisë GGIF Investimenti s.r.l. e lëshuar nga Dhoma e Tregëtisë Industrisë Artizanatit Bujqësisë së Ankonës.
- Shtojca 2:** Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tirana 1 lëshuar më datë 26.01.2006 që ka të bëjë me Terrenin nr. 1.
- Shtojca 3:** Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tirana 1 lëshuar më datë 03.02.2006 që ka të bëjë me Terrenin nr. 2.
- Shtojca 4:** Projekt Marrëveshja Private e Vërtetimit.
- Shtojca 5:** Lista e makinerive në pronësi të Shoqërisë.
- Shtojca 6:** Kopje e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 6754/10 datë 20.09.2005
- Shtojca 7:** “Llogaria Debitorë/Kreditorë” e Shoqërisë në datën 23.02.2006.

* * *

Unë, Noteri ia lexova këtë Kontratë Palëve, të cilat deklaruan se është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Kjo Kontratë që përbëhet nga 7 (shtatë) faqe dhe 12 (dymbëdhjetë) nene, nënshkruhet nga Palët në praninë time, dhe unë Noteri vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

Kjo Kontratë nënshkruhet nga Palët në Tiranë, më datë 24.02.2006.

Shitësi:	 Hillo Apollon MONTILLO AGOSTINO
Blerësi:	Artan Delaku
Noteri:	
Përkthyes:	Gatane Hodari



NOTERE
Mimoza Sadushaj
TIRANE

REPUBLIKA E SHOQËRISË

Shoqëria "Albeton 5" Shpk

V E N D I M

I

ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "ALBETON 5" SHPK



Sot më datë 04, Prill 2007(dymijë e shtatë), pranë zyrave të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, në adresën rruga "Ndre Mjeda", Tiranë, Shqipëri, zhvillohet mbledhja e Ortakut të Vetëm të kësaj Shoqërie.

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Albeton 5" Shpk, është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr 6754, datë 15. 09. 1993, me Seli të saj në adresën : rruga "Ndre Mjeda", Tiranë, Shqipëri.

Me anë të Vendimit Nr. 6754/11, datë 17.07.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është bërë rregjistrimi i Aktit Noterial, Kontratës së Shitjes së Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, me Nr.Rep.991, dhe Nr.Kol.393, datë 24.02.2006, të hartuar dhe nënshkruar para Noteres Mimoza Sadushaj, të Dhomës së Noterisë Tiranë, nëpërmjet së cilës është realizuar blerja e 100%(njëqindpërqind), të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë "Albeton 5", ku Ortak i Vetëm i saj, tashmë është Z.Artan Dulaku i cili zotëron 100%(njëqindpërqind) të kuotave të kësaj shoqërie në kapitalin themeltar të saj.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, Z. Artan Dulaku, i mbledhur rregullisht dhe në gjendje për të vendosur për çështjet sipas rendit të ditës si më poshtë vijon :

1. Ndryshimin e Selisë së Shoqërisë "Albeton 5" Shpk.
2. Përfundimin e Këshillit Administrativ të Shoqërisë.
3. Emërimi i Administratorit të ri.
4. Ndryshimi i Statutit.
5. Të ndryshme të mundëshme.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, Z. Artan Dulaku, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës sipas rendit të ditës, në përfundim :

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e Selisë së Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, të ndodhur në adresën rruga "Ndre Mjeda", Tiranë, në adresën e mëposhtëme :

- Rruga "Perlat Rexhepi", Godina me 2÷13 Kate, Kati i 2, Tiranë, Shqipëri.

2. Të pranojë të përfunduar nga detyra e Këshillin Administrativ të shoqërisë, të emëruar me Vendimin e Gjyqtarit të Vetëm Nr. 6754/3, datës 19.03.2003, duke filluar prej datës 19.09.2006, të përfundimit të afatit trevjeçar, dhe i revokon atyre të gjitha kompetencat e dhëna duke e konsideruar detyrën e tyre si këshill administrativ të përfunduar.

3. Duke e konsideruar të nevojshëm emërimin e një administratori të ri, ortakut i vetëm i shoqërisë, vendos të emërojë duke filluar nga data 02, Prill 2007, Z. Sotiraq Toshi, i biri i Mihallaqit dhe i Donikës, i datëlindjes 17, Shtator 1969, lindur në Korçë, shtetas shqiptar, banues në adresën : rruga "Qemal Stafa" pallati nr.188, shkalla nr.1, apartamenti 2, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me nr. Z.1667349, i cili pranon detyrën e Administratorit Ligjor të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk.

4. Të ndryshojë Nenin 16, të Statutit, si më poshtë :

ADMINISTRIMI

Administrimi i shoqërisë i besohet një apo disa administratorëve, të zgjedhur edhe nga jo ortakët, të emëruar nga asambleja. Kohëzgjatja e detyrës së administratorit/ëve është për një periudhë të pacaktuar, përveç rasteve të dorëheqjes apo revokimit nga asambleja. Ai është përgjegjës përpara shoqërisë ose të tretëve për shkelje ligjore, për shkelje të statutit ose për gabime të kryera gjatë administrimit të tij.

5. Të ndryshojë Nenin 17, të Statutit, si më poshtë :

KOMPETENCAT E ADMINISTRIMIT DHE PËRGJEGJËSITË

Administratori/ët kujdeset dhe vepron bashkërisht ose veçmas në përputhje me kompetencat si më poshtë vijon:

- Të zbatojë vendimet e ortakut të vetëm.
- Të organizojë punën për përmbushjen e objektit të veprimtarisë së shoqërisë duke relatuar tek ortakut i vetëm për miratimin dhe përmbushjen e tyre.
- Të propozojë për ndryshimin e kapitalit.
- Të miratojë rregullat e brendëshme të shoqërisë dhe të personelit.
- Të drejtojë dhe të kontrollojë veprimtarinë e filialeve, agjensive, përfaqësive dhe zyrave të tjera të themeluara nga shoqëria.
- T'i paraqesë propozime asambesë, për përdorimin e fondeve, shpërndarjen e fitimeve dhe likuidimin e borxheve.
- Administratori/ët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkeljet ligjore të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Klauzolat e Statutit që kufizojnë kompetencat e administratorit duhet të respektohen nga të tretët.
- Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur provon se të tretët e dinin se akti i administratorit i kalon kompetencat e tij, apo objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit, pasojat përkatëse.
- Rregullat e këtij neni nuk zbatohen për marrëveshjet që bëhen për operacionet e përditëshme dhe të kryera në kushte normale.
- Ortaku i Vetëm ka të drejtë që, përveç padisë civile për shpërblimin e dëmit, të kërkojë edhe ndjekjen penale kundër administratorëve.

Shoqëria nuk bën ndryshime të tjera të cilat mbeten ashtu siç kanë qenë.

Duke mos pasur gjë tjetër për të cilën duhet të merrej një vendim, Ortaku i Vetëm e deklaroi të mbyllur asamblenë.

Sa më sipër ky vendim dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e Regjistrimit Tregtar.



**SHOQËRIA "ALBETON 5" SH P K
ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**


ARTAN DULAKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1015 Rep.

Nr. _____ Kol.




V È R T E T I M

Sot, në Tiranë, më datë 05, Prill 2007(dymijë e shtatë), ditën e Enjte, përpara meje Noteres **Tamara MALAJ**, pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën “Luigj Gurakuqi” Tiranë, u paraqit personalisht :-----

Z. Artan DULAKU, i biri i Nikos dhe i Lirikës, i datëlindjes 30, Maj 1965, lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën : Rruga “Pjetër Bogdani” Nr. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. **Z 0031648**, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “ALBETON 5” SH.P.K, i cili më deklaroi se, sa më sipër është një Vendim i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “ALBETON 5” SH.P.K, dhe unë, Noterja në bazë të nenit 55, të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për Noterinë” dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë me Nr.6291, të datës 17.08.2005, e vërtetoj nënshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

Tamara MALAJ



REPUBLICA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANE

Nr...1705.....REP.
Nr.....202.....KOL.

V È R T E T I M

Sot më datë 24/02/ 2006, përpara meje Noteres **Ruko SAKO**, së Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht :

Z. Agostino MONTILLO, i datëlindjes 21/11/1946, lindur në Ortona (CH), shtetas Itali, banues në Ankona (AN), via Bocconi n.3, mbajtës i pasaportës me nr. C650218, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili më deklaroi se, sa më sipër është një Vendim i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, dhe unë, Noterja e vërtetoj nënshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

Ruko SAKO



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Ruko Sako'.

VENDIM
I
ORTAKUT TË VETËM
SHOQËRIA "ALBETON 5" SH P K

Nr. 43, datë 24.02.2006



Sot më datë 24. 02. 2006 u mbledh Asmbleja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

Shoqëria "ALBETON 5" Shpk, është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr 6754, datë 15. 09. 1993. Kjo shoqëri e ka Selinë e saj në adresën : rruga "Ndre Mjeda", Tiranë, dhe ka një Ortak të Vetëm Shoqërinë GGIF Investimenti" S.r.l, shoqëri me të drejta italiane, e cila zotëron 100 % (njëqind përqind) të kuotave në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie.

Z. Agostino Montillo, qytetar italian, ne cilesine e likuidatorit te Ortakut të Vetëm të Shoqërisë - GGIF Investimenti Srl, i cili zotëron 100 % të kuotave të kësaj shoqërie, mbledh Asamblenë e Ortakut te Vetëm, të mbledhur rregullisht dhe në gjendje për të vendosur mbi rendin e ditës :

TRANSFERIMI I 100 % TË PJESËVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës, në përfundim,

V E N D O S I :

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, Shoqëria GGIF Investimenti Srl, për arsye objektive vendos që të largohet nga Shoqëria "ALBETON 5" Shpk, dhe është plotësisht dokort t'i transferojë nëpëmjet shitjes të gjitha kuotat e zotëruara prej tij, dhe që përfaqësojnë respektivisht 100 % (njëqindpërqind) të kapitalit të themeltar të shoqërisë "Albeton 5", duke ia shitur personit te meposhtem :


Z. Artan Dulaku, i biri i Nikos dhe i Lirikës i datëlindjes 30.05. 1965, lindur në Tiranë, i cili pranon dhe ble 100% (Njëqind përqind) të pjesëve të kuotave në kapitalin e Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, me një vlere totale prej € 1.000.000/00(njëmilion Euro).

Pas shitjes së kuotave, ortak i vetëm i kësaj shoqërie do të jetë Z.Artan Dulaku, i cili do të bëhet pronar i vetëm në kapitalin e Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, me 100%(një qind përqind) të kuotave të kapitalit.

Shoqëria e mësipërme nuk bën ndryshime të tjera të cilat mbeten ashtu siç kanë qenë.

Sa më sipër ky vendim dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë Zyrës së Rregjistrimit Tregëtar, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e regjistrimit tregëtar.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË
"ALBETON 5" SH P K
Shoqëria GGIF Investimenti Srl
Përfaqësuar nga :
Z. Agostino Montillo



KËRKUESI :

Z. Artan DULAKU, i biri i Nikos dhe i Lirikës, datëlindjes 30/ 05/ 1965 lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z 0031648, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ALBETON 5" SH.P.K.

OBJEKTI :

Depozitimin e Vendimit Nr. 43, të datës 24.02. 2006, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ALBETON 5" Shpk dhe të Kontratës së Shitjes së Kuotave të Kapitalit, me Nr. Rep. 991, dhe Nr. Kol.393, datë 24.02.2006, si dhe të dokumentave të tjera të Shoqërisë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE :

Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar" dhe Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

DREJTUAR :

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

SEKSIONIT TREGTAR

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare", Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k. është regjistruar si person juridik, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Nr. 6754, datë 15.09.1993, me seli në adresën rruga "Abdi Toptani" Torre Drin, kati IV-rt, Tiranë. Shoqëria ka një kapital themeltar në vlerën prej 80.302.244 (tetëdhjetëmilion e treqind e dymijë e dyqind e dyzet e katër) Lekë dhe ortak të vetëm të shoqërisë Shoqërinë "GGIF Investimenti" S.r.l. e cila zotëron 100%(njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, me një kohëzgjatje të veprimtarisë së shoqërisë deri më datën 31. Dhjetor 2020.

Me Vendimin Nr. 43, të datës 24.02.2006, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, është vendosur :

- Largimi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, Shoqëria GGIF Investimenti Srl, për arsye objektive nga Shoqëria "ALBETON 5" Shpk dhe transferimi nëpërmjet shitjes të gjitha kuotave të zotëruara prej tij, dhe që përfaqësojnë respektivisht 100 % (njëqindpërqind) të kapitalit të themeltar të shoqërisë "Albeton 5", duke ia shitur personit të mëposhtëm :

- Z. Artan Dulaku, i biri i Nikos dhe i Lirikës i datëlindjes 30.05. 1965, lindur në Tiranë, i cili pranon dhe ble 100% (Njëqind përqind) të pjesëve të kuotave në kapitalin e Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, me nje vlere totale prej € 1.000.000/00(njëmilion Euro), i cili pas shitjes do të bëhet pronar i vetëm në kapitalin e Shoqërisë Albeton 5" Shpk, me 100%(një qind përqind) të kuotave të kapitalit.

- Kryerjen e të gjithë procedurave ligjore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në kolonat përkatëse të Regjistrin Tregtar.

Me anë të Kontratës së Shitjes së Kuotave të Kapitalit të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, me Rep.991, dhe Nr. Kol.393, datë 24.02.2006, të hartuar dhe nënshkruar para Noteres Mimoza Sadushaj, të Dhomës së Noterisë Tiranë, është bërë shitja e 100% (një përqind) të kapitalit që zotëron Shoqëria "GGIF Investimenti "S.r.l. në favor të Z. Artan Dulaku, me një vlerë prej € 1,000,000/00 (një milion Euro), vlerë e cila është likuajduar totalisht nga blerësi në shumën e dhënë, dhe nuk ka ndaj shitësit asnjë detyrim financiar, e vërtetuar kjo nëpërmjet aktit noterial, Marrëveshje private e vërtetimit, me Nr.Rep. 2331 dhe Nr. Kol. 435, datës 18.03.2006, të noteres publike Ruko Sako, të Dhomës së Noterisë Tiranë.


Pas transferimit të kuotave nëpërmjet shitjes, ortak i vetëm i kësaj shoqërie do të jetë :
Artan Niko Dulaku, i cili bëhet pronar i vetëm me 100% (njëqindpërqind), të kuotave në kapitalin themeltar të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk.

Shoqëria e mësipërme nuk bën ndryshime të tjera të cilat mbeten ashtu siç kanë qenë.

Për sa më sipër, kërkoj nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të bëjë depozitimim e Vendimit me Nr. 43, të datës 24.02.2006, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk dhe të Kontratës së Shitjes së Kuotave të Kapitalit me Nr. Rep.991, dhe Nr. Kol.393, datë 24.02.2006, si dhe të dokumentave të tjera shoqëruese të shoqërisë, në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e regjistrimit tregtar.

KËRKUES

Z. ARTAN DULAKU



- G. Vërtetimi nga Prokuror-Vendues
i Asamblesës Aktive të GGIF
investimenti SRL, dt 30.02.2006.
7. Niveli Nr. 2331 Rep dhe 435 udh
dt 18.03.2006, bami i cili
konfirmimi bami. / bami i bami.
8. P. rubat i bami i bami
Jantja bami dt 18.03.2006.
du bami i bami GGIF Investimenti
SRL
9. G. bami i bami i bami
dt. 06. 04. 2006, konfirmimi nga bami
Jantja i bami
Jantja në dt bami 2006
Gjykatë
Jantja bami

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 1801 Rep.

V Ë R T E T I M

Sot më datë 01, Mars 2006(gjashtë), para meje **Ruko SAKO** Notere Publike, pranë Dhomës së Noterëve Tiranë u paraqit personalisht :-----

Z. Artan DULAKU, i biri i Nikos dhe i Lirikës i datëlindjes 30/ 05/ 1965 lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me **Nr. Z 0031648**, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ALBETON 5 " SH.P.K, i cili më deklaroi se, sa më sipër është një Kërkesë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe unë, Noterja e vërtetoj nënshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE


RUKO SAKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË**

Nr. 7717 Rep.

Nr. 1256 Kol.



**PROKURË E POSAÇME
Neni 70 e vijues të Kodit Civil**

Sot në Tiranë më datën 13, Korrik 2006 (dymijë e gjashtë), përpara meje **Ruko SAKO**, Notere e Dhomës së Noterëve Tiranë, me adresë në Bulevardin "Zogu i Parë", u paraqit personalisht :-----

I PËRFAQËSUARI : Z. Artan DULAKU, i biri Nikos dhe i Lirikës i datëlindjes 30.05.1965, lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën : Ruga "Pjetër Bogdani", Pall. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z. 0031648, i cili më deklaroi se :-----

Emëroj si Përfaqësuese të Posaçme **Zj. Enina JUNIKU**, e datëlindjes 31.07.1974, lindur në Pogradec, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, me profesion Juriste, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Pasaportës me Nr.1168007, të cilës i jap të drejta dhe tagra të plota, që në emër dhe për interesin tim, të paraqitet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe të kryejë të gjitha procedurat për depozitimin e Vendimit Nr. 43, të datës 24.02.2006, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk dhe të Kontratës së Shitblerjes së Kuotave të Kapitalit, me Nr. Rep. 991, dhe Nr. Kol.393, datë 24.02.2006, kontratë në të cilën mbaj cilësinë e palës blerëse të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "Albeton 5" Shpk, si dhe të dokumentave të tjera të Shoqërisë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë . -----

Përfaqësuesja ime, gjithashtu ka të drejtë të marrë pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, dhe të kryejë çdo veprim tjetër të nevojshëm lidhur me këtë porosi, për të bërë të mundur kryerjen e të gjithë procedurave ligjore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e Kontratës së Shitblerjes së Kuotave të Kapitalit, me Nr. Rep. 991, dhe Nr. Kol.393, datë 24.02.2006, dhe pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në kolonat përkatëse të Regjistrit, dhe duke e autorizuar atë, që pas shqyrtimit dhe dhënies së vendimit të Gjyqtarit të Vetëm, të tërheqë atë, nga sporteli i zyrës së sekretarisë gjyqësore, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë. Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesja e posaçme, lidhur me këtë porosi, nga ana ime konsiderohen të drejta dhe të mirëqena, njëllon sikur të ishin kryer prej meje vetë personalisht. -----

Për sa më sipër, përpilohet nga unë noterja kjo prokurë e posaçme, e cila ju lexua me zë të lartë dhe u kuptua nga i përfaqësuari, dhe meqënëse gjendet konformë vullnetit të tij të lirë dhe plotë firmoset regullisht, ndërsa Unë noterja e vërtetoj nënshkrimin e tij dhe këtë prokurë sipas ligjit.-----

I PËRFAQËSUARI

Artan DULAKU

NOTERE

Ruko SAKO

KËRKESË



KËRKUESI :

Z. Artan DULAKU, i biri i Nikos dhe i Lirikës, i datëlindjes 30 Maj 1965, lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z 0031648, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" SH.P.K.

OBJEKTI :

Depozitimin e Vendimit Nr. 44, të datës 04.04.2007 të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ALBETON 5" Shpk, dhe të dokumentave të tjera të Shoqërisë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE :

Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar" dhe Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

DREJTUAR :

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË SEKSIONIT TREGTAR

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare", është regjistruar si person juridik, Shoqëria "Albeton 5" Sh.p.k., me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Nr. 6754, datë 15.09.1997, me Selinë në adresën rruga "Ndre Mjeda", Tiranë, me kapital themeltar të shoqërisë në vlerë prej 6,367.252 (gjashtëmilion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) Lekë, me Ortak të Vetëm të shoqërisë, Z. Artan Dulaku, i cili zotëron 100% (njëqind për qind) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Me Vendimin e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, me Nr. 44, të datës 04.04.2007, është vendosur :

1. Ndryshimin e Selisë së Shoqërisë "Albeton 5" Shpk, të ndodhur në adresën rruga "Ndre Mjeda", Tiranë, në adresën e mëposhtëme :
- Rruga "Perlat Rexhepi", Godina me 2÷13 Kate, Kati i 2, Tiranë, Shqipëri.
2. Të pranojë të përfunduar nga detyra e Këshillin Administrativ të shoqërisë, të emëruar me Vendimin e Gjyqtarit të Vetëm Nr. 6754/3, datës 19.03.2003, duke filluar prej datës 19.09.2006, të përfundimit të afatit trevjeçar, dhe i revokon atyre të gjitha kompetencat e dhëna duke e konsideruar detyrën e tyre si këshill administrativ të përfunduar.
3. Duke e konsideruar të nevojshëm emërimin e një administratori të ri, ortaku i vetëm i shoqërisë, vendos të emërojë duke filluar nga data 04, Prill 2007, Z. Sotiraq Tosha, i biri i Mihallaqit dhe i Donikës, i datëlindjes 17, Shtator 1969, lindur në Korçë, shtetas shqiptar, banues në adresën : rruga "Qemal Stafa" pallati nr.188, shkalla

nr.1, apartamenti 2, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me nr.Z.1667349, i cili pranon detyrën e Administratorit Ligjor të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk.

4. Të ndryshojë Nenin 16, të Statutit, si më poshtë :

ADMINISTRIMI

Administrimi i shoqërisë i besohet një apo disa administratorëve, të zgjedhur edhe nga jo ortakët, të emëruar nga asambleja. Kohëzgjatja e detyrës së administratorit/ëve është për një periudhë të pacaktuar, përveç rasteve të dorëheqjes apo revokimit nga asambleja. Ai është përgjegjës përpara shoqërisë ose të tretëve për shkelje ligjore, për shkelje të statutit ose për gabime të kryera gjatë administrimit të tij.

5. Të ndryshojë Nenin 17, të Statutit, si më poshtë :

KOMPETENCAT E ADMINISTRIMIT DHE PËRGJEGJËSITË

Administratori/ët kujdeset dhe vepron bashkërisht ose veçmas në përputhje me kompetencat si më poshtë vijon:


- Të zbatojë vendimet e ortakut të vetëm.
- Të organizojë punën për përmbushjen e objektit të veprimtarisë së shoqërisë duke relatuar tek ortakut i vetëm për miratimin dhe përmbushjen e tyre.
- Të propozojë për ndryshimin e kapitalit.
- Të miratojë rregullat e brendëshme të shoqërisë dhe të personelit.
- Të drejtojë dhe të kontrollojë veprimtarinë e filialeve, agjensive, përfaqësive dhe zyrave e të tjera të themeluara nga shoqëria.
- T'i paraqesë propozime asambesë, për përdorimin e fondeve, shpërndarjen e fitimeve dhe likuidimin e borxheve.
- Administratori/ët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve, për shkeljet ligjore të Statutit apo faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Klauzolat e Statutit që kufizojnë kompetencat e administratorit duhet të respektohen nga të tretët.
- Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur provon se të tretët e dinin se akti i administratorit i kalon kompetencat e tij, apo objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit, pasojat përkatëse.
- Rregullat e këtij neni nuk zbatohen për marrëveshjet që bëhen për operacionet e përditshme dhe të kryera në kushte normale.
- Ortaku i Vetëm ka të drejtë që, përveç padisë civile për shpërblimin e dëmit, të kërkojë edhe ndjekjen penale kundër administratorëve.

Shoqëria nuk bën ndryshime të tjera të cilat mbeten ashtu siç kanë qenë.

Për sa më sipër, kërkoj nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të bëjë depozitimin e *Vendimit të datës 04.04.2007, të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Albeton 5" Shpk dhe të dokumentacionit bashkëlidhur, në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e regjistrimit tregtar.*

K Ë R K U E S

Z. ARTAN DULAKU




ALBETON 5 sh.p.k
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1016 Rep.

Nr. _____ Kol.




V È R T E T I M

Sot, në Tiranë, më datë 05, Prill 2007(dymijë e shtatë), ditën e Enjte, përpara meje Noteres **Tamara MALAJ**, pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën "Luigj Gurakuqi" Tiranë, u paraqit personalisht :-----

Z. Artan DULAKU, i biri i Nikos dhe i Lirikës, i datëlindjes 30, Maj 1965, lindur në Tiranë, shtetas Shqiptar, banues në adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. **Z 0031648**, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ALBETON 5 " SH.P.K, i cili më deklaroi se, sa më sipër është Kërkesa drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe unë, Noterja në bazë të nenit 55, të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994, "Për Noterinë" dhe Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë me Nr.6291, të datës 17.08.2005, e vërtetoj nënshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

Tamara MALAJ



NOTERË
TAMARA MALAJ
Rr. L. GURAKUQI . P.2. AP. 21
TIRANË
05.04.2007



**RELACION
I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR
PER VLERESIMIN E PJESEVE TE KAPITALIT TE ZOTERUARA NGA SHTETI
QE DO TE PRIVATIZOHEN
NE SHOQERINE "ALBETON 5" SH.P.K**

I. OBJEKTI I DETYRES

Une Adriatik Beqiraj , Ekspert Kontabel i Autorizuar, anetar i Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar me licence profesionale numur 72, me vendimin e Asamblese se Ortakeve nr 39 date 26.11.2004 te shoqerise "Albeton 5 " sh p k me eshte besuar dhe kam pranuar detyren ,

- Kryerjen e vleresimit te pjeseve te kapitalit qe zoterohen nga Shteti (Ministria e Ekonomise) ne shoqerine "Albeton 5 " sh p k, qe do te privatizohen


II. METODA E VLERESIMIT

Per vleresimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga shteti (Ministria e Ekonomise) qe do te shiten , ne shoqerine me kapital te perbashket "ALBETON 5 " sh p k , ne pajtim me VKM nr 230 date 04.04.1998, dhe udhezimeve ne zbatim te tij ,ne pamundesi te zbatimit te metodave te tjera , kam perdore metoden e vleresimit te ketyre pjeseve mbeshtetur ne

- *Vleren kontabel te kapitaleve te veta te shoqerise qe rezultojne sipas Bilancit dhe pasqyrave perkatse te mbyllura me date 28.02.2005, te audituara nga ana ime ,*
- *Raportin ne perqindje te pjeseve te kapitalit te zoteruara nga shteti ne kapitalin themeltar te shoqerise me date 28.02.2005*
- *Vleresimin e truallit ne pajtim me aktet ligjore e nenligjore ne fuqi, per kuotim te cmimit te pjeseve te kapitalit shteteror qe do te shiten*

III. BAZA LIGJORE DHE DOKUMENATACIONI MBESHTETES

- Ligji nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare "
- Ligji Nr 7661 date 19.01.1993 "Per kontabilitetin "
- V.K.M nr 230 date 04.04.1998 "Per privatizimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga shteti ne shoqerite me kapital te prbashket"
- V.K.M nr 21 date 21.01.1999 "per disa ndryshime ne V.k.M 230 date 04.04.1998
- Udhezimin nr 106 date 01.07.2003 te Ministrise Ekonomise "Per zbatimin e V.K.M nr 230 date 04.04.1998."
- Proces Verbalin e mbledhjes asamblese se ortakeve date 26.11.2004 "per miratimin e shitjes te pjeseve te kapitalit qe zoterohen nga shteti "
- Shkresa e Zyres Regjistrimit te Pasurive te Paljteshme nr 3980.1 date 17.01.2005 nr 3980/1 date 18.01.2005 ne pergjigje te shkreses se Ministrise Ekonomise nr 7557 date 08.12.2004 per vleren mesatare te truallit ne zonen perkatse.
- Dokumentat e themelimit te shoqerise "Albeton 5" sh p k dhe ndryshimet ne vijim te tyre ,
- Bilanci kontabel dhe pasyrat perkatase te mbyllura me 28.02.2005
- Bilancet ekonomiko financiare te shoqerise prej themelimit te saj,
- Dokumentacioni tjeter ligjor e kontabel i mbajtur nga shoqeria.



VI. TE DHENA PER SHOQERINE

1. Organizimi dhe ortaket

"ALBETON 5" sh.p.k. është themeluar si Ndermarrje me kapital të perbashket Italo-Shqiptar, në baze të autorizimit të Ministrisë Tregëtisë e Bashkëpunimit me Jashtë Nr 78 date 1993, ndërmjet:

1. Shoqërisë "G.G.I.F INVESTMENT" "S.r.l. person juridik italian regjistruar në Regjistrin Tregëtar në Ancona Itali me numur 20588, përfaqësuar nga z. Luigi Fabri, dhe
2. SHTETI SHQIPETAR me ish "Ndermarrja Prodhimit Materialeve të Ndertimit nr 5" me seli në rrugën "Ndre Mjeda" Tirane, person juridik shqiptar, e përfaqësuar nga Drejtori Dhimiter Dervishi ligjërësht i autorizuar

Në pajtim me ligjin Nr 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë Tregëtare" dhe Nr 7667 date 28.01.1993 "Për regjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregëtare", me kërkesën e drejtimit të shoqërisë dhe me vendim të Gjykatës së Rrethit Tirane nr 6754 date 15.09.1993 është regjistruar në regjistrin tregëtar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) me përberjen e ortakeve, që janë:

1. Shoqëria "G.G.I.F INVESTIMENTI" "s.r.l. person juridik italian me seli në Ancona Itali, përfaqësuar nga z. Luigi Fabri, dhe
2. "Ndermarrja e Prodhimit Materialeve të Ndertimit Nr 5" Tirane, e përfaqësuar ligjërësht nga personat e autorizuar nga organet shtetërore përkatëse.

Mbeshtetur në ligjin 7926 date 20.04.1995 ndryshuar me aktet ligjore të tjera në vijim, zotëruese e pjesëve të kapitalit të zotëruara nga shteti në shoqëritë me kapital të perbashket është Ministria e Ekonomisë,

Me date 28.02.2005 ortaket në shoqërinë "Albeton 5" sh.p.k., janë

1. Shoqëria "G.G.I.F INVESTIMENTI" "s.r.l. person juridik italian me seli në Ancona Itali, përfaqësuar nga z. Luigi Fabri, dhe
2. Ministria e Ekonomisë, e përfaqësuar ligjërësht nga personat e autorizuar nga Ministri i Ekonomisë.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të ligjit Nr 7638 date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", sipas akteve të themelimit të saj dhe legjislacionit tjetër shqiptar

Administrimi

Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakeve,
- Këshilli administrativ

Vendimet merren nga Asambleja e Ortakeve

Selia e shoqërisë është në Tirane, Rruga "Abdi Toptani", Torre Drini kati IV.

2. KAPITALI THEMELTAR, PJESET E KAPITALIT, KONTRIBUTET

A. Kapitali themeltar dhe pjesët e kapitalit.

Shoqëria me kapital të perbashket Italo Shqiptarë, "Albeton 5" sh.p.k. është regjistruar si person juridik Shqiptar me vendimin e Gjykatës Rrethit Tirane Nr 6754 date 15.09.1993.

Në vendimin e Gjykatës Nr 6754, për regjistrimin në Regjistrin Tregëtar, sipas formës që përdoret në ato vite, nuk është shënuar vlera e kapitalit themeltar dhe pjesët e kapitalit të ortakeve.

Adriatik Beqiraj

120



Ne mbledhjen e dyte te asamblese ortakeve date 12.11.1993 shenohet se bazuar ne bilancin e dates 30.06.1993 , kapitali i themeltar dhe pjeset e kapitalit te ortakeve ne kapitalin themeltar ne shoqerine „Albeton 5 „ sh p k, jane miratuar :

- G.G.I.F Investimenti „ S.r.l 340 788 usd = 36 464 316 leke, ose 60 %
- Shteti me ish N.P.M.N nr 5 227 192 usd = 24 309 544 leke ,ose 40 %
- Kapitali themeltar 567 980 usd = 60 773 860 leke ,ose 100%

B.Kontributet e paleve ne kapitalin themeltar perbehen :

- „G.G.I.F Investmente“ Sr 1 merr pjese me kontributet teresisht ne para per investimet e parashikuara .
- Shteti Shqipetar merr pjese me kontributet ne natyre me pasurite e ish „NPMN nr 5 „, te vleresuara ne aktet e vleresimit ne pajtim me aktet ligjore e nenligjore ne fuqi nga komisionet e vleresimit te ngritura per kete qellim, sipas bilancit date 30.06.1993 , te cilat ndodhen ne shoqeri, dhe ne menyre te permbledhur jane :
 - Trualli per 62 184 m2 me vlere 3 230 000 leke
 - Ndertesa me vlere 5 321 000 leke
 - Makineri e linja 5 660 500 leke'
 - Mjete trasporti 1 003 300 leke,
 - Inventar ekonomik 142 300 leke ,
 - Aktive qarkulluese 8 952 044 leke
 - Gjithsej kontributi 24 309 544 leke

Per kembimin nga Usd ne leke eshte perdore kursi 1 usd =107 leke,kursi ne ate periudhe i fiksuar edhe ne pasqyrat e vleresimit te pasurise se Ish" N.P.M.N nr 5 „, dhe vlersimit te truallit nga Sektori Financave ne Bashki.

Ne mbledhjen e dyte te asamblese ortakeve me date 12.11.1993, bazuar ne te dhenat e bilancit kontabel te mbyllur me date 30.09.1993, eshte miratuar dhe vendosur te rritet vlera e kontributit te shtetit me ish" N.P.M.N nr 5" ne kapitalin themeltar ne shoqerine „Albeton 5" sh p k , per 30084 USD, dhe per te ruajtur raportet e pjesemarrjes ne kapitalin themeltar, po ne kete mbledhje eshte vendosur qe edhe ortaku jo shteteror te marre pjese me rritjen e kontributeve dhe pjeseve ne kapital.

Rritjet ne kontributet e ortakeve te miratuara ne mbledhjen e dyte te asamblese paraqiten :

- „G.G.I.F Investment „Srl 45 125 USD = 4 828 375 leke , ose 60 %
- Shteti (ish N.P.M.N nr 5)" 30 084 USD = 3 219 160 leke, ose 40 %
- Gjithsej rritje ne kapital 75 209 usd = 8 047 535 leke, ose 100 %

Per kembimin dhe parqitjen ne leke dhe ne usd eshte perdore kursi historik 1 usd = 107 leke

Me kete rritje, kotributet, pjeset e kapitalit te ortakeve ne kapital dhe kapitali themeltar me date 01.10.1993 , date kejo e fillimit te shoqerise, arrijne ne vlerat :

- G.G.I.F Investment“ S r l 385 914 usd = 41 292 691 leke ,ose 60 %
- Shteti (ish“ N.P.M.N nr 5"),257 276 USD = 27 528 704 leke,ose 40 %
- Kapitali themeltar 643 190 usd = 68 821 395 leke ,ose 100 %

Keto vlere jane ne perputhje dhe sipas nenit 3 te kontrates dhe nenit 9 te statutit te shoqerise ne momentin e regjistrimit si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar „Albeton 5" sh p k .Ne dokumentat e shoqerise jane pasqyruar derdhjet e kontributeve nga Ortaket.

(Handwritten signature)

(Handwritten number 121)



Me vendim te Asamblese se ortakëve ne mbledhjen date 13.03.1994, fitimi pas tatimit i realizuar ne bilancin e vitit 1993 per 1 942 671 leke eshte perdore per rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise dhe pjeseve te kapitalit te ortakëve sipas perqindjeve te pjesemarrjes ne kapital.

Rritja e kapitalit te nenshkruar, pjeseve te kapitalit dhe kontributeve paraqitet:

- G.G.I.F Investiment" Srl 11 656 USD = 1 165 602 leke, ose 60 %
- Shteti, (ish N.P.M.N 5) 7 771 USD = 777 069 leke, ose 40 %
- Rritje ne kapitalin themeltar 19 427 usd = 1 942 671 leke ose 100 %

Pas kesaj rritje, kontributet, pjeset e kapitalit te ortakëve, dhe kapitali themeltar arrijne ne vlerat:

- "G.G.I.F Investiment "Srl 397 570 Usd = 42 458 439 leke, ose 60 %
- Shteti, me ish N.P.M.Nnr 5" 265 047 USD = 28 305 627 leke, ose 40 %
- Kapitali themeltar 662 617 USD = 70 764 066 leke, ose 100 %

Me vendim te asamblese se ortakëve ne mbledhjen date 05.09.1995, eshte vendosur qe nga fitimi I realizuar ne vitin 1994 sipas llogarive vjetore, pas zbritjes se tatimit dhe rezervave te nevojshme ne pajtim me statutin dhe aktet ligjore, shumta e fitimit te paktuar 4 279 446 leke te kaloje ne rritje te kapitalit themeltar dhe pjeseve te kapitalit te ortakëve sipas perqindjeve te pjesemarrjes ne kapital.

Rritja e kontributeve, pjeseve te kapitalit te ortakëve dhe kapitalit themeltar, paraqitet:

- G.G.I.f Investiment "Srl 27592 USD = 2 567 668 leke, ose 60%
- Ministria e Ekonomise 18 394 USD = 1 711 778 leke, ose 40%
- Rritja ne kapital 45 986 USD = 4 279 446 leke, ose 100 %

Per kembimin nga leke ne Usd eshte perdore kursi I Bankes B Sh 1 usd = 93,06 leke.

Pas kesaj rritje, kontributet, pjeset e kapitalit te ortakëve, dhe kapitali themeltar arrijne ne vlerat:

- G.G.I.f Investiment "Srl 425 162 usd = 45 026 107 leke, ose 40 %
- Ministria e Ekonomise 283 441 usd = 30 017 405 leke, ose 60 %
- Kapitali themeltar 708 603 usd = 75 043 512 leke, ose 100%

Me vendim Nr 6754/2 date 26.03.1999 te Gjykates se Shkalles pare Tirane jane depozituar ne regjistrin Tregetar dokumentat per zmadhimin ne kapitalin themeltar te shoqerise, I cili behet 75 043 512 leke.

Me vendim te asamblese se ortakëve nr 34 ne mbledhjen e saj date 09.03.2004, eshte vendosur qe shumta e fitimeve te rezervuara ne formen e provizioneve per rreziqe per lehtesite tatimore te kushtezuara te perfituara sipas akteve ligjore per shumen 6 367 252 leke, te kaloje ne rritje te kapitalit themeltar si kontribute te ortakëve ne raport me perqindjet e pjesemarrjes se tyre ne kapitalin e nenshkruar.

Rritja e kontributeve, pjeseve te kapitalit te ortakëve dhe kapitalit themeltar te shoqerise paraqitet:

- G.G.I.f Investiment "Srl 35 704 usd = 3 820 351 leke, ose 60 %
- Ministria e Ekonomise 23 803 usd = 2 546 901 leke, ose 40 %
- Rritje kapitalit themeltar 59 507 usd = 6 367 252 leke, ose 100%

Per kembimin dhe parqitjen ne usd eshte perdore kursi historik 1 usd = 107 leke

Pas kesaj rritje, kontributet, pjeset e kapitalit te ortakëve, dhe kapitali themeltar arrijne ne vlerat:

172



- G.G.I.F Investiment "Srl 460 866 usd = 48 846 458 leke, ose 60 %
- Ministria e Ekonomise 307 244 usd = 32 564 306 leke, ose 40 %
- Kapitali themeltar 768 110 usd = 81 410 764 leke, ose 100%

Me vendim nr 6754/5 date 26.05.2004 te Gjykates Shkalles Pare Tirane eshte depozituar ne Regjistrin Tregtar dokumentacioni per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise i cili behet 81 410 764 leke

Me vendimin e asamblese Ortakeve nr 38 date 12.11.2004 ,eshte vendosur zvogelimi i kapitalit themeltar te shoqerise per vleren 395 900 leke, e cila i referohet vleres se truallit prej 10 000 m² x 39,59 leke/m² te ndodhur ne sektorin e Farkes prane fshatit Stermas , sipërfaqe e cila sipas vendimit nr 218 dt 05.06.1995 te K.K.P, dhe nr 805 date 25.06.2004 te Gjykates se Apelit Tirane i kthehet ish pronareve.

Kjo sipërfaqe trualli 10 000 m² eshte pjese e sipërfaqes ne sektorin Farke Stermas prej 28 000 m² e cila ne momentin e themelimit eshte perfshire ne kapitalin themeltar te shoqerise "Albeton 5 " si kontribute te ish" N.P.M.N nr5 "

(28 000 m² x 39,59 leke/m² = 1108520 leke, e vleresuara nga Seksioni i Finances se Keshillit rrethit Tirane me dokumentin date 14.07.1993 me vleren ne nivelin e qerase vjetore 39,59 leke per m²)

Vlera qe zvogelon kapitalin themeltar prej 395 900 leke, zvogelon edhe kontributin e ortakut shtetor , Ministrine e Ekonomise, per 10000 m² truall dhe pjeset e kapitalit per 395 900 leke.

- Kontributet e Ortakut shtetor, Ministrise Ekonomise, behen
32 564 306 leke - 395 900 leke = 32 168 406 leke
- Kontributet e Ortakut " G.G.I.F Investiment "Srl mbeten pa ndryshuar
48 846 458 leke

Sipërfaqe e truallit sektorit Farke dhe vlera e tij perfshire ne kontributet e ortakut shtetor behen :

Trualli prej 28000 m² - 10 000m² = 18 000 m² ,

vlera 1108520 leke - 395 900 leke = 712620 leke leke .

Pas ketij zvogelimi , kontributet, pjeset e kapitalit te ortakeve dhe kapitali themeltar , ne shoqerine "Albeton 5 "sh p k , paraqiten :

- G.G.I.F Investiment "Srl 460 866 USD = 48 846 458 leke , ose 60,29 %
- Ministria e Ekonomise 303 544 usd = 32 168 406 leke , ose 39,71 %
- Kapitali themeltar 764 410 USD = 81 014 864 leke , ose 100 %

Me vendimin Nr 6754/7 date 17.11.2004 te Gjykates Shkalles Pare Tirane eshte depozituar ne Regjistrin tregetar dokumentacioni per ndryshimin e pjeseve dhe zvoglimin e kapitalit themeltar si me sipër.

Me vendimin Nr 40 date 15.02.2005 ,Asamble e Ortakeve te shoqerise 'Albeton 5 " sh p k ka vendosur te zbritet nga kapitali i shoqerise , kuota e Ortakut shtet, vlera e truallit te sektorit te Farkes.

Sipërfaqe dhe vlera e truallit sektorit Farke, e perfshire ne kapitalin themeltar te shoqerise si kontribute te ortakut shtetor me daten 15.02.2005 (date e mbledhjes se Asamble eOrtakeve) eshte eshte 18000 m² x 39,59 leke/m² = 712 620 leke.

Vlera e truallit Sektori Farkes, qe zbritet nga kontributet e pjeset e kapitalit te Ortakut shtetor si dhe nga kapitali themeltar i shoqerise , ne baze te vendimit utr 40 date 15.02.2005 te Asamblese Ortakeve, eshte

Adriatik

173



$18000 \text{ m}^2 \times 39,59 \text{ leke /m}^2 = 712\,620 \text{ leke}$

Vlersimi i truallit eshte bere me vleren e dhene ne momentin e themelimit.

Si efekt i kesaj zbritje,

- Vlera e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga shteti ne kapitalin themeltar te shoqerise behen $32\,168\,406 \text{ leke} - 712\,620 \text{ leke} = 31\,455\,786 \text{ lek}$
- Vlera e pjeseve te Ortakut jo shteteror mbetet $= 48\,846\,458 \text{ leke}$
- Kaoitali themeltar behet $81\,014\,864 \text{ leke} - 712\,620 \text{ leke} = 80\,302\,244 \text{ leke}$.

Mbas ketij paksimi, kontributet, pjeset e kapitalit te seicilit ortak dhe kapitali themeltar i shoqerise „Albeton 5 „sh p k behen :

- G.G.I.F Investimenti "Srl 460 866 USD = 48 846 458 leke ,ose 60,83 %
- Ministria e Ekonomise 296 820 usd = 31 455 786 leke. ose 39,17 %
- Kapitali themeltar 757 687 USD = 80 302 244 leke , ose 100 %

Me vendimin Nr 6754/8 date 28.02.2005 te Gjykates Shkalles Pare Tirane eshte depozituar ne Regjistrin Tregetar dokumentacioni per ndryshimin e pjeseve dhe zvoglimin e kapitalit themeltar si me siper.

Me date 28.02.2005, ne bilancin operativ, kontributet, pjeset e kapitalit dhe kapitali themeltar ne shoqerine "Albeton 5" sh p k, rezultojne te jene :

- G.G.I.F Investimenti "Srl 460 866 USD = 48 846 458 leke ,ose 60,83 %
- Ministria e Ekonomise 296 820 usd = 31 455 786 leke. ose 39,17 %
- Kapitali themeltar 757 687 USD = 80 302 244 leke , ose 100 %

Nga verifikimet e kujdesshume qe kam kryer ne dokumentacionin kontabel dhe krahasimet me dokumentat te tjera ligjor qe disponon shoqeria, te paraqitura ne lidhje me perberjen e ndryshimet ne kontributet, pjeset e kapitalit te ortakeve, dhe ne kapitalin themeltar te shoqerise ,u konstatua se ato jane ne perputhje me vendimet e asamblese se Oerakeve dhe jane pasqyruar ne menyre te rregullt ne Pasqyrat financiare te shoqerise "ALBETON 5" sh p k prej themelimit te saj deri ne me date 28.02.2005

VI. VLERSIMI I PJESEVE TE KAPITALIT TE ZOTERUARA NGA SHTETI NE SHOQERINE ME KAPITAL TE PERBASHKET "ALBETON 5" SH P K QE DO TE SHITEN .

Per vleresimin e pjeseve te kapitalit te zoteruara nga shteti (Ministria e Ekonomise) qe do te shiten ,ne shoqerine me kapital te perbashket "ALBETON 5" sh p k , ne pajtim me VKM nr 230 date 04.04.1998, dhe udhezimeve ne zbatim te tij ,ne pamundesit te zbatimit te parimeve te tjera , kam perdore metoden e vleresimit te ketyre pjeseve mbeshtetur ne

- Raportin ne perqindje te pjeseve te kapitalit te zotruara nga shteti ne kapitalin e nenshkruar te shoqerise "Albeton5" sh p k me date 29.02.2005 , e cila eshte 39,17 %
- Vleren kontabel te kapitaleve te veta te shoqerise qe rezultojne sipas Bilancit te mbylltur me date 28.02.2005, te audituara nga ana ime, te cilat jane 23.583.093 leke.
- Vleresimin e truallit ne pajtim me aktet ligjore e nenligjore ne fuqi, per kuotim te cmimit te pjeseve te kapitalit shteteror qe do te shiten.

KAPITALET E VETA TE SHOQERISE

Gjendja e kapitaleve te veta te shoqerise "Albeton 5" sh p k sipas bilancit kontabel te mbylltur me date 28.02.2005 rezultojne te jene :

(Handwritten signature)
124



